DOCUMENT RESUME

ED 177 890 FL 010 631

TITLE	Albanian: Basic Course. Military Interpreting Practice, Vol. 1.
INSTITUTION	Defense Language Inst., Monterey, Calif.
PUB DATE	Jul 66
NOTE	84p.; For related documents, see FL 010 626-630 and FL 010 632-648
AVAILABLE FROM	Defense Language Institute, Foreign Language Center, Nonresident Instruction Division, Presidio of Monterey, CA 93940
LANGUAGE	Albanian; English
EDRS PRICE	MF01/PC04 Plus Postage.
DESCRIPTORS	Adult Education; *Albanian; Audiolingual Methods; *Classroom Materials; Glossaries; *Instructional Materials; *Language Instruction; *Military Science; Postsecondary Education; *Second Language Learning; Speech Communication; Uncommonly Taught Languages; Word Lists

ABSTRACT

This first of two volumes presents materials designed to supplement "Albanian: Basic Course" in the area of military science. The first section consists of parallel lists of questions on military subjects in English and Albanian. The second section is a list of 200 military questions in Albanian only. The third section is an English-Albanian words list of military terms. (JB)

****
* Reproductions supplied by EDRS are the best that can be made *
* from the original document. *
****

ED017890

A L B A N I A N

Basic Course

Military Interpreting Practice

Volume I

"PERMISSION TO REPRODUCE THIS MATERIAL HAS BEEN GRANTED BY
Defense Language Institute
TO THE EDUCATIONAL RESOURCES INFORMATION CENTER (ERIC)."

U S DEPARTMENT OF HEALTH, EDUCATION & WELFARE
NATIONAL INSTITUTE OF EDUCATION

THIS DOCUMENT HAS BEEN REPRODUCED EXACTLY AS RECEIVED FROM THE PERSON OR ORGANIZATION ORIGINATING IT. POINTS OF VIEW OR OPINIONS STATED DO NOT NECESSARILY REPRESENT OFFICIAL NATIONAL INSTITUTE OF EDUCATION POSITION OR POLICY

July 1966

DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE

FL010631

When you were in the Albanian Army, what kind of weapon did you have ?

Kishem nji pushkë ruse.

What was your rank and what branch of the Army were you in ?

Ishem ushtár i thjeshtë në kembësorí.

How many light machineguns did you have in a company ?

Kishim vetëm katër, d.m.th. nji për çdo togë.

How many people were there in an infantry company ?

Çdo kompaní kishte afërsisht 200 vetë.

How many officers were in your company ?

Kishim nji kapiten si komandant kompanije dhe nji toger e nji nëntoger për çdo togë.

What was the educational background of your officers ?

Disa prej tyne kanë krye shkolla ushtarake ndër shtetet satelite, të tjerët kanë krye shkollën ushtarake në Tiranë.

How was the food you had in the Army ?

Kishem me thânë se gjella nuk ishte as e mirë as e keqe.

How many years did you serve in the Army ?

Kam ndejtë n'ushtrí 47 muaj, me fjalë tjera pothuaj katër vjetë.

Were you stationed always in the region of Elbasan during this period ?

Jo, 16 muajt e fundit kam punuar në Zyrën e Rekrutimit në Gjinokastër.

What was your rank when you left the Army ?

Ishem rreshter. Po të kishem ndejtë edhe dy muaj do t'ishem gradue kapter.

For how long were you in the reserve before being called in for the second time ?

Ndejta në rezervë për pothuaj dy vjetë e gjysmë.

Thank you for the information.

S'ka përse.

What's your name ?	Kristo Telka.
When and where were you born ?	Kam lé në Himarë, Shqipní me 17 Qershuer 1927.
Are you married ?	Po, kam grue dhe nji djalë shtatë vjeç.
What was your rank in the Albanian Army ?	Ishem major.
In what branch of the service did you serve ?	Në fillim kam shërbye në kambësorí dhe tre vjetët e fundit në njisít e tanksavet.
Tell me, what division were you in ?	Në divizionin "Vijosa".
What's your education ?	Kam krye Shkollën Ushtarake në Tiranë dhe nji kurs në Moskë mbi mjetet e korracueme.
When did you graduate from the Military School ?	Më 1950. Më 1952 kreva kursin në Moskë dhe u-kthéva menjiherë në Shqipní.
Were you a member of the Communist Party ?	Po, për tre vjetë. U-përzuna nga partija më 1953 mbassi shkrova në Revistën Ushtarake diçka që nuk i pëlqeu Komandantit të Shtabit.
And then what happened ?	Mbas dý javësh mora urdhën transferimi për në Korçë.
How long were you stationed in Korça ?	Deri në verën e kalueme kur filluem manevrat e përgjithëshme.
How did you escape to Yugoslavia ?	Gjatë manevravet divizioni im u-ndodh për do kohë afër kufinit . Nji natë së bashku me dy oficera tjerë dolëm në Jugosllaví.

5

Corporal, bring in the first man to be questioned !

Po, Zotní Kapiten, qe ku âsht.

What's your name, rank and serial number ?

Jam rreshter Qazim Përlati dhe kam si numër ushtarak numrin 679-385.

When and where were you taken prisoner ?

U-dorëzova të marten që kaloi në nji njisi tuejën afër lumit.

Why did you surrender ?

Gjatë muejit që kaloi kam qenë i sëmundë dý herë dhe s'kishim ilaçe. Kur m'erdhi rradha për transferim majori s'më la me shkue e më mbajti aty...

What major ?

Komandanti i batalionit, Major Pinari.

Why didn't he let you go ?

Më tha se s'kishim mjaft njerëz, mbassi kohët e fundit kemi pasë shumë humbje.

How many casualties have you had in your battalion during the last battle ?

Kishem me thânë se 30% e batalionit tonë u-nxuer jashtë luftimi.

How many tanks do you have left ?

Unë s'kam pá asnji në gjendje të mirë. Shumica e tyne nuk mund të lëvizi nga vendi; disa janë të prishun dhe të tjerëvet u mungojnë pjesë të ndryshme.

Don't you receive spare parts with your supplies ?

Ç'prej kur janë prishë urat në mbrapavijat s'kemi marrë furnizime...

What do you do; how do you live and fight ?

Marrim aq sa me jetue e për të mbajtë frontin. I sjellin natën me kuaj ase në dorë grupe civilash të mobilizuem.

How many people are there altogether that carry the supplies ?

Nuk e dij me siguri por do të thojshem nja 250 njerëz e nja 30-40 kuaj.

Are those people dressed in uniform ?

Jo. Si thash më parë janë civila të komanduem nga nënoficera t'ushtris.

Stop, put your hands up !

Mirë, mirë, por mos gjuemi. Ç'doni prej meje ?

Come forward and don't lower your hands !

Mos u-bâni marak se nuk i ul duert; s'kam qejf të vdes.

I see you're not armed. What are you doing here ?

Unë kaloj çdo natë këndej e s'më ka ndalë njeri më parë. Kush jeni ju ?

It's none of you business who we are. There must be some (military) barracks around here, tell us where they are !

Jeni gabim, këtu afër s'ka ndonji kazermë as ka ushtarë.

Come on, speak up or maybe you would like to come along with us.

Ku doni me më çue ? A mos keni zbarkue këtu e doni me dijtë se ku janë kazermat për t'i sulmue e shkatrrue ?

You're right ! Now tell us how far the barracks are from here !

Tash e kuptoj ! Në muejt e parë të luftës, nja 5 km. prej këndej, kanë qenë disa kazerma dërrasash por verën e kalueme ushtrija i lëshoi.

You mean that around here there isn't a single Army barracks ?

Keni të drejtë. Ç'prej ditës që ushtrija i lëshoi kazermat s'kam pá ndonji ushtár këndej.

That's not true ! Two days ago our airplanes saw the barracks and there were motor-vehicles all around them. How do you explain that ?

Ndërtesat janë aty por tash shërbejnë si magazina për prodhime bujqësore e vegla pune.

What were the trucks doing there ?

Zyra e Bujqësís i dërgoi me marrë bereqetin për t'a çue deri në stacion të trenit nja 1¼ km larg. Tash kazermat ase më mirë me thânë magazinat janë bosh; mbrenda s'ka veçse vegla bujqësore.

Are we supposed to believe you ?

Mos u-bâni marak; ju kam thânë të vërtetën, do t'a shifni vetë. Për t'a provue le të vijnë tre prej jush me mue t'u tregoj magazinat e të shofin se ç'kanë mbrendë.

I understand that you belong to the 2nd Battalion. Tell me in which unit of the 2nd Battalion ?	Në Kompanín Antitanks.
Where were you going when our patrol caught you ?	Po shkojshem në nji nga topat tonë.
What kind of guns (cannons) do you have in your company ?	Topa antitanks 75 milimetrash.
How many of these guns do you have in your company ?	Kompanija ka trí toga dhe çdo togë ka tre nga këta topa.
What's the range of a 75 mm. gun ?	Ky top mund të shtjerë në nji largësi 1800 metrash.
Where is the place to which you were going located ?	Ku bashkohet rruga e Selës me rrugën e Vithkuqit.
How many guns do you have there ?	Vetëm nji.
How many armed soldiers guard it ?	Këtë llogore ka nji skuadër kumbësorije me nji mitroloz të rëndë.
What else do you have there ?	Kemi vë dy automjete të shkatrruesme me dhé e penë për të zënë rrugën.
Where is the other platoon located ?	Ruejnë vendin që mos të afrohen tanksat nga krahu tjetër i batalionit. Tamam ku nuk e dij.
How much ammunition do you have for each gun ?	Nga 30-40 predha rregullisht. Nganjiherë ndoshta më shumë ase më pak.
How many men do you have in your company, Lieutenant ?	Tre oficera e tetëdhetë ushtarë.
What kind of weapon were you carrying when you were caught ?	Pushkë automatike kalibër .30.

What's your name, Sergeant ?

Bashkim Selfo.

What unit were you in ?

Ishem në togën e 2të të kompanís së 3të të tanksavet të lehtë.

What were your duties in the 2nd platoon ?

Ishem kapteri i togës.

What kind of tanks did you have in your platoon ?

Tanksa të lehtë me topa 76 milimetrash.

How many tanks did your platoon have ?

Katër, por vetëm tre morën pjesë në betejën e fundit.

What was your mission when you were taken prisoner ?

Toga ime dhe toga e 3të e kompanís sonë do t'i ndihmojshin kambësorís gjatë sulmit.

How would you help the infantry ?

Porsa filloi sulmi tanksat hapën rrugën . Kur i u-afruem objektivit tanksat duhet të ndaleshin e të gjuejshin, kështu që kambësorija të shkonte përpara.

How many infantry soldiers were you supporting in this attack ?

Nji batalion dhe nji togë të xhenjos.

Did you leave at the same time as the other platoon ?

Po, u-nisëm së bashku por në dý rrugë të ndryshme dhe u-bashkuem nja 3 km. para objektivit.

Why did you leave on two different roads ?

Kishim frikë nga ndonji sulm ajruer.

Didn't you have anti-aircraft guns ?

Nuk mjaftojshin me ndalue nji sulm ajruer. Unë kam pá vetëm tre topa.

What was the other plan for this attack, in case it would rain ?

Urdhëni që më dha togë-komandanti ishte që sulmi të fillonte si ishte parapá. Po të binte shí i madh, sulmi do t'ushtynte të paktën 48 orë mâ vonë.

9

Good morning, Lieutenant; did you send for me ?

Merr nji karrigë e ulu këtu afër tryezës, Zotní Marshall.

What's new, Lieutenant ?

Sonte do të dërgojmë dý patrulla; nji matanë lumit dhe tjetrën po t'a tregoj në hartë se ku.

What time will they leave, what time will they come back and what kind of information will they gather ?

Mund të nisen si zakonisht. Patrulla e parë duhet të mundohet me zânë ndonji rob lufte e t'a sjell, ndër vijat tona.

This is a very hard task, Sir. I don't know if it will be possible !

Në rasë të kundërt duhet të mbledhin informata të përgjithëshme mbi tanksat që ndodhen n'at sektor.

Is it possible to get all this information in one night ?

Jo. Patrulla e parë do të ketë ushqim për dý ditë e dý netë. Qe këtu në hartë se ku âsht zona e tyne. A ke ndonji pyetje ?

No. How about the other patrol, the one that will go across the river ?

Ata do të shkojnë me pá pozicionet e topavet dhe mundësisht se çfarë topash...

We got that information one week ago, Sir !

Aeroplanat tonë kanë pá dje se u kanë ardhë nja 8-9 topa tjerë. S'ka me qenë e vështirë për patrullën me i zbulue mbassi do të jenë tue i vendosë ndër pozicione.

What do you think, Sir; what kind of guns will they be ?

Nuk e dij, por ndoshta topa 155 mm. Të shofim kur të këtnehet patrulla do t'a dijmë me siguri.

When will the second patrol be back, Sir ?

Duhet të këthehet para se të fillojë me zbardhë. Due që n'orën gjashtë të mëngjesit të kemë raportën e tyne këtu.

Yes Sir, anything else ?

Për tash s'ka tjetër. Epi kryetarit të patrullës së dytë nji kopje të kësaj harte e të shenojë mbi tô pozicionin e topavet.

Where is your 120 mm. mortar company located ?

Nuk e dij. Kam ndigjue se gjindet në pýll pranë bregut të lumit por nuk jam i sigurtë.

What unit were you in ?

Kam bâ pjesë në Kompanín e 3të të Batalionit të 4të të Divizionit të 2të.

How come you don't know exactly where the 120 mm. mortar company is located ?

Unë kam bâ pjesë gjithëmonë në patrullë. Nuk e dij se ku gjindet kjo ase ajo njisí.

What were your duties in the 3rd Company ?

Ishem kryetár skuadre, por si thash...

OK,OK ! How many patrols did your battalion send out every 24 hours ?

Vetëm nji; patrullën teme, por jo çdo 24 orë. Kishem me thânë se shkojshim në patrullë mesatarisht pesë herë në javë.

How many people were there in your patrol ?

Mvaresh nga vendi e nga informatat që duhet të mblidhshim. Nganjiherë katër vetë, ndonji herë tjetër gjashtë ase shtatë.

It seems to me that you were very proud of being patrol leader !

Sigurisht jam kryenaltë. S'ka njeri në të gjithë divizionin që e di vendin, në këtë anë të lumit, si e dij unë.

How many of our men did you capture during the past four weeks ?

Gjatë katër javëvet të fundit kemi zânë rob pesë ushtarë tuej...

How is it possible ? We have lost 12 men in the last four weeks in clashes with patrols !

Ndoshta janë vrá. Na kemi hudhë në lum nja katër trupa ushtarësh të vdekun.

How many casualties did you have during this period ?

Më le të mendoj pak. Në këto katër javë kemi humbë shtatë njerëz.

When were you drafted ?

Më kanë marrë ushtár në Tetuer të 1956-s. U-gradova kapter në Mars për zotësí që tregova si kryetár patrulle.

Lieutenant, tell the intelligence officers to report to my office right away.

Si urdhënoni, Zotní Kolonel, por vetëm kryetari i zyrës së shërbimit të fshehët âsht oficer; tjerët janë nënoficera.

OK then, tell the Major to come to me.

Po e thërras në telefon njitash. Në pak minuta do të jetë këtu.

Come in Major. Take a chair and sit down, please. Did you bring the last reports with you ?

Si urdhënoni Zotní Kolonel; kam me vete të gjitha informatat e pesë ditëvet të fundit.

We are going to prepare an attack plan within 48 hours; show me on the map where the enemy forces are concentrated.

Pjesa mâ e madhe âsht e përqëndrueme në këtë luginë n'anë të majtë të rrugës. Nja tre batalionа gjinden në këtë fshat e në pýll pranë fshatit.

Where are their armor units concentrated ?

Mjetet e korracueme janë pak a shumë të shpërdame. Këtu janë pikat se ku dhe sa tanksa ka në çdo vend...

Where are their guns located and tell me if they can be seen from the air .

Âsht shumë e vështirë që të dallohen nga ajri. Shumica e topavet janë të fshehun në buzë të këtij pylli. Në bazë t'informatavet nuk duhet të kenë shumë topa.

In case they decide to withdraw, which direction would they take ?

Kanë vetëm nji rrugë. Mund të tërhiqen nga Jug-Prendimi e të bashkohen me pjesën tjetër të korparmatës. Pse, a mendoni se mund të tërhiqen pa...

I don't think so but I want to foresee what could happen.

Nga ana tjetër mund të parashifni se po nga ai drejtim mund t'u vijnë ndihma.

Where do they keep their ammunition ?

Municionin e mbajnë ndër llogore e ndër gropa të mëdhaja të fshehuna në pýll. Këtu në hartë janë shenue se ku, por këto informata nuk janë të sigurta.

What time is the attack to take place ?

Njisija jonë do të vëhet në lëvizje n'orën 4 të mëngjesit së bashku me tanksat e me batalionin e 3të.

We thought we would go alone; I mean without the tanks.

Deri në nji farë vendi do të shkojmë së bashku, mandej do të dahemi nga tanksat e nga nji pjesë e batalionit të 3të.

You mean that a part of the 3rd batalion is coming along with us ?

Ky âsht urdhëni që kam marrë nga komandanti i batalionit; pse, a nuk ju pëlqen që të shkojmë me nji pjesë të batalionit të 3të ?

It doesn't matter but the point is:where are we going with(a)part of the 3rd battalion ?

Si ju thash më parë, nesër në mëngjes do të fillojë sulmi...

Oh, come on Sergeant, you can tell us something more. After all we are moving in a few hours !

Hollësít do të ju a thom nesër para se të nisemi. Misioni ynë âsht të nxjerrim jashtë luftimi nji bateri topash.

Do you think we'll be able to pass through their line of fire and get to the artillery ?

Kur të fillojë sulmi, na do të shkojmë mbrapa tanksavet të lehtë. Kur të arrîjmë afër pyllit do të dahemi prej tyne e nga pjesa e madhe e batalionit të 3të.

And then what's going to happen ?

Do të qëndrojmë aty për nja 30 minuta që të jemi të sigurtë se nuk na kanë zbulue; pastaj do të shkojmë drejt objektivit tonë.

How far is the enemy's battery from that point ?

Nuk âsht shumë larg. Kishem me thânë nja 1.5 km. Duhet të arrîjmë aty para orës 10 e të shkatrrojmë topat.

Why before 10 o'clock ? How about if we can't...

Sepse n'orën 10 do të vijë vala e dytë e sulmit me tanksat e rândë. Ai do të jetë sulmi i vërtetë.

What's your name, Corporal, and what unit did you belong to ?

Thoma Prevenza dhe kam bá pjesë në Regjimentin e 2të të Divizionit IX.

When did you land on this island ?

Në mëngjesin e të martes që kaloi.

What were you doing and where were you going when we caught you ?

Kishem humbë rrugën dhe po u-mundojshem t'orientoheshem se nga me shkue.

How did you get lost ?

Unë qesh caktue si vëzhgues dhe dje në mëngjes, kur desha të këtheheshem në njisín teme, humba rrugën.

Which unit ? Your regiment ?

Jo, në kompanín e 3të.

How far was your company from the coast when you left them ?

Nuk e dij. Mund t'ishin 3 km. si mund t'ishin 20 km. larg. S'kam asnji idé.

You are not telling the truth, Corporal. How come you don't know the distance ?

Si pret që t'a dij. Unë kam zbarkue pesë ditë má parë e për trí ditë s'kam luejtë nga vendi se ishte shí...

OK. How many regiments would you say have landed with you or after you ?

Unë kam zbarkue nga nji vaporr transporti me regjimentin tem dhe u-futëm nja 700 m. në pýll. S'dij se kush tjetër ka zbarkue me ne ase mbas nesh.

How many transports were in the bay when you landed ?

Unë pashë vetëm nji luftanije. Kishte aq shumë mjegullë sa nuk ishte e mundun me pá má larg se 150 m.

When you landed, did you see any armor or cannons on the beach ?

Jo, s'kam pá asnji, por pashë gjurmë tanksash në buzë të pyllit.

How far was the rest of the regiment from the point where you landed ?

Nji kompaní ishte nga e djathta ime dhe disa njisí tjera má të vogla nga e majta.

Which company of the 3rd regiment were you in ?	Në Kompanín e 4të, por ditën që filloi sulmi më transferuen në Kompanín e 2të.
How much of the front line did the 2nd Company cover ?	Kishem me thánë nja 400 m. por kishim me né edhe nji togë të Xhenjos.
What did you do when the attack began ?	Toga e Xhenjos na hapi rrugën nëpër fushën e minuame tue e pastrue nga minat.
Did you have any casualties while crossing the minefield ?	Vetëm nji ushtár i Xhenjos u-plague në krah nga nji predhë e artilerís suej. Áskush tjetër.
And then what happened ?	Menjiherë u-ndeshën me vëzhguesit e pararojës suej. Kishin zënë pozicion mdër llogore dhe si duket na kishin pá e po na pritshin. Papritmas hapën zjarrn dhe vranë nja dhetë prej nesh.
How long were you forced to stop during this action ?	Lajruem menjiherë artilerín dhe mbas nji gjymës ore e kaluem edhe at pengesë. Humbën gjithësejt nja pesëmëdhetë vetë.
What happened to our outpost, did they surrender ?	Nji pjesë u-vrá; disa tjerë hikën dhe kusuri u-dorëzue. Artilerija dhe mortajat tona i shkatrruen fare.
Weren't our tanks there ?	Tanksat erdhën pak vonë; pothuej mbas njizet minutash që mori fund beteja.
How and when did you get wounded ?	Tanksat nuk dijshin se ç'kishte ngjá. Kur erdhën afër llogorevet i sulmuem befas. Në këtë ndeshje u-plagova...
How long did it take to put the tanks out of action ?	S'ishin veç 6 tanksa; mbas 10 minutash asnjáni prej tyne nuk mund të lëvizte më nga vendi.
Where did your company go after they treated your wounds and left you ?	Morën urdhën me shkue menjiherë në ndihmë të Kompanís së 3të që gjindesh nga e djathta jonë.

Hello, Mr.Preza, please sit down !

Zotní Kapiten, due me dijtë pse më keni sjellë këtu. Unë jam civil. S'kam punë me ushtrín ! Ç'doni prej meje ?

Have a cigarette, Mr.Preza ! I just want to have a little information about the terrain behind the enemy lines.

Ka shumë kohë që nuk kam qenë përtej rrugës së Burrelit. Nuk e dij, ndoshta shumë gjâma mund të kenë ndryshue.

I'm only asking you to tell me what you know; for instance, how far the fortifications are from the brook !

Besoj se prroni âsht nja 70 m. mbrapa fortifikatavet por në disa vende âsht fare afër, pothuej 10-12 m.

What kind of fortifications are they ?

Çdo 200 m. ka nji fortifikatë të mbulueme me beton që mund të zâjë nja 10-12 ushtarë. Fortifikatat lidhen me njâma tjetrën me anë llegoresh...

Are the trenches covered in any place ? Are their walls concrete and how wide are they ?

Llegoret janë të mbulueme. Në disa vende kanë mure betoni e gjetiu e mbajnë dhén me dhasë me ranë. Kështu ishin tre vjetë më parë. Besoj të jenë 1.5 m. të gjâna.

Do they have obstacles in front of them ?

Po, ka pengesa prej betoni për tanksa nëpër ato vende ku mund të kalojnë tanksat, ndër vende tjera ka tel me gjemba.

How wide or, better to say, how deep are these obstacles ?

Pengesat për tanksa janë nja 12 m. në thellësí. Telat me gjemba ishin në dy rradhë. Rradha e parë nja 4 m. mandej nji rryp toke beson e prap nji rradhë tjetër nja 6-7 m. e gjânë.

What would you say was the distance between the trenches and the obstacles ?

Kishem me thânë afro 70 m. Aty këtu pak më shumë ase më pak.

Can you recall in what month you saw them last ?

Më kujtohet se ishte vjeshtë por s'më kujtohet muejt.

Sergeant, bring in the major that was captured the day before yesterday !

Si urdhënoni, Zotní Kapiten. Tash sa e sollën nga burgu i përgjithëshëm. Qe ku âsht.

How is your wound, Major ? Do you feel any better now ?

Po, besoj se po. Tash jam në gjendje të qëndroj më kambë e nuk kam ethe. Jam shumë më mirë se sa kur më zûtë.

I want to chat a little with you. Here is a chair, Major; sit down, please !

Ju falem nderit. Çka doni të dini, Zotní Kapiten ?

When did you parachute behind our lines and how many other officers were with you ?

Më vjen keq Zotní Kapiten, por nuk mund të ju tregoj as se kur më hodhën me parashutë as se sa oficera tjerë ka me grupin e rezistencës.

OK, tell me then the names of some of the resistance leaders and where their HQ's are located !

Se ku gjindet qendra e tyne nuk e dij e sa për emnat e tyne as këtë nuk mund të ju a tregoj. Jam rob lufte e si i tillë nuk jam i detyruem me tregue tjetër veçse...

Let me remind you, Major, that you were caught behind our lines. You are a spy and you know how spies are treated !

Ju po harroni nji gjâ, Zotní Kapiten. Kur më zûtë, unë ishem n'uniformë dhe si e shifni jam ende n'uniformë. Jam pjesëtar i Fuqivet t'Armatosuna dhe kërkoj të trajtohem si i tillë e jo si spiun.

You were caught behind our lines therefore you are considered a spy. Whether you were in uniform or not, it doesn't matter.

Unë kam pasë urdhën nga komanda ime me qenë gjithëmonë n'uniformë. Në bazë të Konventës së Gjenevës kërkoj të më trajtoni si çdo rob lufte.

If you give us a little information, you'll help yourself. On the other hand, we treated your wounds and we are treating you very well, as you can see !

Ju falem nderës shumë si për mjekimin ashtu edhe për trajtimin që më keni bâ por çâshtja e informatavet âsht nji punë tjetër. Jam i sigurtë se edhe ju, po t'ishi në vendin tem do të kishi bâ të njâjtën gjâ.

OK, Major. It depends entirely upon you. I hope you'll not repent later on.

Nuk besoj, Zotní Kapiten.

Why did you surrender, Corporal ?

Gjatë ndeshjes së fundit mbetëm pa municion dhe vendosëm me u-tërhjekë, por qe tepër vonë mbassi ishim të rrethuem.

Did your company commander order you to withdraw or did you decide by yourself ?

Morëm urdhën nga komanda jonë me qëndrue deri në fund dhe mandej, po t'ishte e mundun, të tërhiqeshim.

Do you know why you were ordered to keep your position to the end ?

Kështu që të gjitha kompanít të kishin lohë me u-tërhjekë matanë prronit...

Is it there that they are going to make their next stand ?

Nuk e dij ! Thash matanë prronit mbassi aty ishte vendi ku do të mblidheshim në rasë tërhjekje.

What was the purpose of this attack ? Why didn't your armor show up ?

Nuk dij as arsyen e sulmit as pse tanksat nuk morën pjesë në këtë luftim. Unë s'bëj plane lufte !

How and by whom were you given the attack orders ?

Kapteri i togës na njoftoi të bâheshim gati për sulm. Na dha nji orë afat. As ai nuk e dinte, a së paku nuk na tregoi neve, qëllimin e sulmit.

Who assigned you to the machinegun position ?

Kur i u-afruem kodrës kapteri i togës sime caktoi pesë prej nesh në pozicionin e mitrolozit të radhës.

Who was in charge of the position ?

Rreshter Xhelali, por u-vrá para se të mrrijshim, kështu që u-bâna unë përgjegjësi i pozicionit.

Why did you wait that long to surrender ?

Si ju thash ky ishte urdhëni që mora nga komandanti im e nga ana tjetër prej nesh mvaresh jeta e shokëvet që po tërhiqeshin.

How many of you were there in the position when you surrendered ?

Vetëm dy, të tjerët u-vranë gjatë luftimit.

What were you doing when our patrol caught you ?

Po shkojshem në komandën e divizionit me dërgue postën.

What were your duties in the 5th Company ?

Kam qenë i atashuem komandës së regjimentit. Ishem postier (lajmtar).

What were you carrying with you when you were caught ?

Kishem nji pushkë të shkurtë automatike, gjashtë karikatorë dhe dy bomba dora.

What else ? Haven't you forgotten something ?

Nuk besoj. S'kishem asgjá tjetër me vete.

You said that you were the battalion's messenger and that you were carrying the mail to the division. Where is the mail ?

Kur ndigjova zhurmë hoqa çantën nga krahu dhe e fsheha në nji kaçubë. Mbas pak minutash më zunë rob.

Could you find the place where you hid it ?

Po të jetë ditën ndoshta po. Natën s'ásht e mundun mbassi mbrëmë ishte e para herë që i rashë asaj rruge.

Do you take the mail to the Division Hq's at night, often ?

Jo, shumë rrallë, kur ka diçka urgjente. Gjatë natër muejvet të fundit vetëm tri herë kam çue postën natën.

How is the mail sent in the daytime ?

Të shumtën e herës me ndonji automjet. Kur ka shumë borë a shí e mbyllet rruga e dërgojnë me kalë.

How many times did you personally take the mail to the division ?

Nja 20 a 25 herë gjithësejt çprej ditës që m'atashuen pranë regjimentit.

What did you do the rest of the time ?

Shpërdajshem postën ndër batalionat e ndër kompanít e ndryshme.

Nothing else ?

Nganjiherë bájshem rojë natën, asgjá tjetër.

How long have you been in this sector of the front ?

Kam ardhë me 6 Gusht, d.m.th. tash shtatë muej e gjymës.

What's you name, rank, serial number and what unit are you in ?

Mue më quejnë Vangjel Starova dhe jam ushtár i thjeshtë. Kam bá pjesë në Divizionin "Shkumbini" dhe kam si numër ushtarak numrin 279-591.

What unit of the "Shkumbini" Division are you in ?

Më Kompanín e 12të të Regjimentit të 3të.

What were your duties in the 12th Company ?

Në fillim më patën caktue si ndihmës mitralieri në togën e 5të dhe tash nji muej isheva me njisít e pararojës.

How come you were alone when we captured you ?

Njisija ime më caktoi të shkojshem me vëzhgue terenin. U-largova prej tyne nja dhetë minuta dhe u-futa në pyll.

Then what did you do ?

Për të pá më mirë kypa në nji pemë. Mëdërsa po u-ngjitsheva më rrëshqiti kamba e rashë peshtë.

Did you faint before or after you fell ?

Duhet të kem përplasë kokën në ndonji degë sepse s'më kujtohet kur rashë përdhé.

Look at this map now. Here is where we captured you. In what direction of this point did you leave the rest of your unit ?

Kishem me thënë nga Jug-Lindja e kësaj pike...

How many were you and what kind of weapons were you carrying with you ?

Ishim 17 vetë dhe kishim me vete dy mitroleza të lehtë. Pjesa më e madhe kishin pushkë të shkurta automatike.

When was your unit supposed to return to the rest of the outpost ?

Do të këtheheshim para se të bâhesh terr, në rastë të kundërt do t'i njoftojshim me anë të nji lajmtari.

What do you think ? Will they go back this evening ?

Pa tjetër. Kishim vendosë qysh më parë të këtheheshim para orës 18.

What was the name and rank of the patrol leader ?

Nëntoger Jusuf Karrili.

What's your name and rank ?

Kapiten Xheladin Qyrka.

What unit were you in ?

Kam qenë në Regjimentin e 5të të Divizionit "Tomori".

What were your duties in the 5th Regiment ?

Kam punue në komandën e divizionit si oficer ndërlidhës.

Why were you carrying with you an identification card released only to security officers ? Come on, Captain, tell the truth !

Jam kapiten i Seksionit të Sigurimit t'Ushtris, e mandej ?!

What did you do before the war ? Where were you employed ?

Jam oficer i karierës. Kam qenë gjithënonë n'ushtrí çprej ditës që kam dalë nga shkolla.

What school did you graduate from ?

Kam krye Akademin Ushtarake në Brno, Çekosllovakí.

OK, Where were you going when we caught you ?

Po shkojshem në Komandën e Batalionit të 4të për të pyetë disa robë lufte.

What do you do with the prisoners of war after you question them ?

I çojmë ndër fusha përqëndrimi.

All of them, without distinction ?

Jo, kemi nji vend të posaçëm ku mbajmë njerzit që mendojmë se mund të na nevojiten mâ vonë.

Where is this place located ?

S'kam asnji idé se ku mund të jetë.

Is it a concentration camp like the others, a prison or what is it ?

Nuk dij gjâ; por nuk besoj të jetë burg. Besoj të jetë nji lloj fushe përqëndrimi ku ndoshta i trajtojnë pak mâ mirë se robët tjerë të luftës.

How do you select the ones that you send to this particular concentration camp ?

Në bazë të detyrës që kishin n'ushtrí, të punëvet që bâjshin para se me hŷ n'ushtrí ase vetëm në bazë t'emnit të tyne.

When were you captured, Corporal ?

U-dorëzova vullnetarisht ndër vijat tueja dje në mëngjes ?

How come you decided to desert your own army ?

Ka 16 muej që më hudhin nga nji sektor të frontit në nji tjetër dhe kjo më ka demoralizue shumë.

This is the only reason ?

Jo, ka edhe më. Ka më se dy vjetë e gjysëm që s'kam pá familjen. Kur kërkova 15 ditë leje komandanti i kompanís më tha se kishte të tjerë para meje.

Didn't he tell you when your turn would come to go on a 15 day leave ?

Po, më tha. Më qoftë se çdo gjá do të shkonte mirë do të më vînte rradha mbas 7-8 muejsh.

Wouldn't it have been better if you had waited 7 or 8 months ?

Sido që të bâhesh kishem vendosë mos me kalue edhe nji dimën tjetër në front në konditat që ishim.

In what condition(s) were you ?

S'kam hangër nji gjellë të ngrofët tash dy muej. Ka 10 ditë që nuk hajshim tjetër veçse bukë misri që mykun e djathë. Kishim vazhdimisht urí.

How is the morale of the troops in that sector of the front ?

Ju e kuptoni vetë se si mund të jetë morali i ushtarëvet me ushqimin që kishim e me jetesën që bâjshim. Më shikoni mue e do të shifni shumicën e atyne të shkretëve që janë aty.

We are in November and it has been snowing these last few days. What were you supposed to do when it snowed ?

Me ndejtë ndër llogore e me u-ngrí, çka tjetër ! Kam ndigjue se komandanti i regjimentit kishte kërkue leje dý herë nga Komanda e Divizionit me u-tërhjekë, por s'i kanë dhânë leje.

Do you know the place where he asked permission to withdraw ?

Nja njizet kilometra deri në fshatin Kaçor, kështu që së paku nji pjesë e ushtarëvet t'ishin të strehuem gjatë dimnit.

Thank you for your cooperation, Corporal.

22

Come in, Corporal, and sit down !

Ju falem nderit, Zotní Toger.

Did you have a good rest last night ?

Kam hangër e kam fjetë fare mirë dhe e ndiej veten t'aftë për të bâ çfarëdo pune fizike.

From your papers I saw that you were born in Istok. Where does your family live ?

Të gjithë njerzit e mij banojnë n'Istok. Aty kam jetue deri ditën që më morën ushtár.

How would you like to work for us, Corporal, for instance to go back behind your lines and gather information for us ? We'll pay you !

Ju falem nderit, Zotní Toger, por unë dezertova nga ushtrija ime e s'due me rá në belá. Unë kënaqem me pak e të hollat s'më hŷjnë në punë. Preferoj të jem rob lufte.

I'll make a proposition to you. If you'll agree to go twice behind your lines to gather information, I'll let you go home for 15 days.

Si âsht e mundun: fshati im âsht matanë frontit !? Jeni tue bâ shaka, Zotní Toger ?

I forgot to mention to you that our troops occupied Istok last night. We have launched a big offensive on that part of the front.

Me kët lajm ndryshojnë punët. Çfarë informatash doni që të mbledh ?

Then you agree to work for us ?

S'kam mënyrë tjetër se si mundem me pá familjen ; Pranoj, po !

You'll go dressed as a civilian with an assumed name. Nobody will recognize you.

Mvaret nga vendi ku do të shkoj e nga informatat që do të mbledh.

Now another officer will come and he'll show you the sector where you'll gather the information.

Po dokumentat e rrobet civile, ku do t'i marr ?

Don't worry ! You'll get from him also your new papers. As for the civilian clothes, I'll arrange for you to have them.

Mirë, jam gati.

What unit were you in, Lieutenant ?

Kam bâ pjesë në njisín e aviacionit vëzhgues të Divizionit "Korabi".

You mean that you were an officer of the Air Force attached to the Army ?

Jo tamam. Jam oficer i ushtrís dhe bâjshem pjesë në nji njisí t'Aviacionit Vëzhgues t'Ushtrís.

How many of you were there in your unit ?

Ishim 32 oficera e nji kompaní ushtarësh të komanduem nga nën-oficera.

How come there were 32 officers in one company ?

Ishim 32 mbassi të gjithë pilotët dhe vëzhguesit duhet të jenë oficera.

What were your duties ? Are you a pilot ?

Po, jam edhe pilot por kryesisht jam vëzhgues fotograf.

What kind of a camera have you been using ?

Aparat fotografik model ŠR 710 me objektiv TL. Ngarjiherë merrshim edhe në film.

How did you communicate with your base ?

Me radion që gjindesh n'aeroplan.

On what wave band did you communicate ?

Nuk e dij. Çdo radiomarrëse e radiodhânëse mër aeroplanat tanë e ka të rregullueme gjatësín e valëvet kur instalohet aparati.

What kind of an airplane were you in when you were hit ?

N'aeroplan vëzhgimi BOC-27.

What kind of armament has this type of airplane and what is its speed ?

Nuk ka kundërfarë armatimi dhe ka nji shpejtësí mesatare 300 kilometrash n'orë.

What happened to the pilot of the airplane; why didn't he parachute out like you did ?

Mbassi u-qëllue, aeroplani filloi të marri zjarm. Nuk jam i sigurtë por më duket se piloti kishte vdekë nga nji plumb në kokë sepse e kishte krejt fytyrën me gjak.

How high was the airplane flying when it was hit ?

Kishem me thânë nja 1200-1300 m. nalt.

How many airplanes of this type were there in your unit ?

Tetë aeroplana BOC-27 e katër aeroplana vezhgimi me reaksion model TU-4.

What's your name and rank and what was the name of the ship you were on ?

Më quejnë Perlat Kadriu dhe jam rreshter i Marinës. Ishem me detyrë mbi anijen "Rozafat".

What kind of a ship was the "Rozafat" ?

Ishte vaporr për transportim trupash e materiali.

What year was the ship built ?

Nuk ishte nji vaporr nga më modernët por e bânte punën e vet. Ishte bâ në vjetin 1922 në Gjermani.

What were your duties on the ship ?

Kam qenë në Sekcionin e Sinjalevet.

How many men made up the crew of the "Rozafat" ?

Ishim gjithësejt 112 vetë: oficera, nënoficera e marinarë.

Do you know what caused the sinking of your ship ?

Dý janë shkaqet, ja nji torpilë ase ndonji plasje në repartin e motoravet.

How long did it take for the transport to sink after the explosion ?

Kishem me thânë nja 7-8 minuta. Me siguri jo më shumë se dhetë minuta.

What was your cargo on this trip ?

Si zakonisht: gjâna ushqimi, pak veshmbathje e municion për armë të lehta; ndoshta edhe copa për automjete e tanksa.

How come you weren't with a convoy ? Did you have any escort ships ?

At mbrâme do të takoheshim me nji karvan anijesh të shoqnueme nga luftanije e nëndetse.

What was the name and rank of the "Rozafat" CO ?

Kapiten Xhemal Abazi.

Where were you to unload the cargo ?

Nuk e dij. Zakonisht në gjymës të rrugës merrshim urdhën se ku duhet të shkojshim. Kur nisemi as Kapiteni vetë nuk e di se ku do të shkojë.

What did you do right after the explosion ?

Ishem tue shkue në zyrën e Kapitenit... Plasja duhet të më ketë hudhë në det sepse u-gjeta papritmas n'ujë.

What branch of the Army did you belong to ?	Kam bá pjesë n'Artilerín Bregdetare.
What's your rank ?	Këto kohët e fundit kam qenë gradue kapter.
How long have you been in the Army ?	Ç'prej ditës që në morën ushtár nuk kam dalë má nga ushtrija; tash 15 vjetë.
During this time, have you always been in the Coast Artillery ?	Jo, kam shërbye për katër vjetë në Rojën e Kufínit.
Is the Border Guard a branch of the Army or is it an independent outfit ?	Asht nji degë më vete që mvaret nga Ministrija e Mprojtjes Kombëtare. Ka lidhje të ngushta me ushtrín por s'âsht pjesë e saj.
Why did you leave the Border Guard and go back in the Army ?	Kishin mungesë personeli e më patën transferue përkohësisht në Rojën e Kufínit.
Where were you stationed last ?	Nja 12 km. në Lindje të fshatit Burizë; në breg të detit gjindet nji bazë ushtarake. Aty ishem unë.
How many men were there in that camp ?	Pesë kompaní; gjithësejt nja 900 vetë.
How far are the barracks and the HQ's from the coast ?	Po të kem nji hartë do të ju a tregoj.
Here is the map, show it to me !	Qe, këtu në këtë pýll janë nja 10 ndërtesa provizore që shërbejnë si banesa e zyra.
Where do you keep the ammunition and where do you do your repair jobs ?	Nga e majta e ndërtesavet ka katër çadra të mëdhaja që shërbejnë si ofiçinë. Municionin e mbajmë aty-këtu në grumbuj të mbuluem me copa çadrash.
If someone wanted to go to town, did he have to ask for a pass ?	Po, duhet të merrshim leje të veçantë tue tregue arsyen pse dojshim me shkue.

26

What's your name and where is your ID card, Sergeant ?

Më quejnë Xhaferr Spahiu dhe letërnjoftimi është mbi tryezë tënde.

What branch of the Army were you in ?

A nuk e shikon shenjën e Trupit Mjeksuer në jakën e xhaketës ?

I want you to tell me; I don't want to guess; answer as soon as I ask you !

Shiko, Zotní Toger; unë u-aratisa nga ushtrija ime e po vazhdove të silleshi në këtë mënyrë unë nuk do të të përgjegj fare !

I thought you were taken prisoner ! I'm sorry, Sergeant. Here, have a cigarette.

Të falem ndërit. Çka dojshe me dijtë ?

What unit of the Medical Corps were you in ?

Bâj pjesë në Trupin Mjeksuer të Regjimentit të 4të.

What were your main duties ?

Jam infermier. Bâjshem mjekimet e para të plagosunvet që vijshin nga fronti.

How far from the front line was the hospital located ?

Spitali në të cilin ishem unë ishte nja 5 km. larg nga fronti. Ishte nji spital fushuer me 40 shtretën.

Was the hospital in a building or in a tent ?

Në fillim ishte vetëm në ndërtesën e shkollës, pastaj i shtuem edhe nji çadër të madhe për brijë.

How many doctors and nurses were there to take care of the wounded ?

Kishte pesë doktora e dhetë infermierë e infermiere.

How many ambulances did the hospital have ?

Nuk e dij me saktësí por kishem me thânë nja 10-12 autoambulanca.

Was there any other hospital close by ?

Jo. Spitali më i afërt ishte në Bulqisë, 25 km. larg.

By what means did you take the wounded to the hospital ?

Me autoambulanca e me helikoptera. Pranë spitalit kishim nji vend të posaçëm ku zbritshin helikopterat.

What's your name, Lieutenant, and what unit did you belong to ?

Më quejnë Kristaq Vangjo dhe kam bë pjesë në Batalionin e 5të të Regjimentit të 3të të Divizionit "Shkëlzeni".

Were all the men of the 5th Battalion in the Engineer Corps ?

Po. Me përjashtim të nji skuadre, që të gjithë ishim të Xhenjos.

How long have you been in this sector of the front ?

Kam ardhë këtu vjet në Qershuer, d.m.th. tash 9 muej.

Very well, Lieutenant. Have you ever been on the road that passes through the Zilishti Valley ?

Jo. Kur erdha në front udhëtova me tren, me kamion dhe 30 kilometrat e fundit i bëna me helikopter.

Do you have any idea what condition the road is in ?

Nji ditë kam shkue me inspektue nji urë të vogël e rruga m'u-duk në përgjithësi në kondita mjaft të mira.

Have all the bridges been repaired ?

Nuk e dij me siguri, por dy muej më parë ishin ende tue punue në to.

How many bridges, large and small, could there be in the last 35 kilometers ?

Të të gënjej, s'kam asnji idé.

Do you know anything about the road,if it is paved at any place ?

Kam ndigjue se gjatë 35 kilometravet të fundit pothuej se gjymsa , vende vende âsht e shtruame.

Where were you stationed before you came here ?

Ç'prej fillimit të luftës kam qenë pothuej gjithënji tue punue ndër aeroporte.

What kind of work did you do ?

Ndreqshim dhe shtrojshim aeroportet që damtoheshin nga bombardimet.

In what condition are your airfields, generally ?

Në kondita mjaft të mira. Pothuej se në të gjitha çohen e ulen aeroplanat.

Can jet airplanes land on all your airfields ?

Po. Të gjitha aeroportet janë zmadhue në mënyrë që mund të zbresin e të çohen aeroplanat reaktivë.

28

Sergeant, bring in for interrogation the first man who was arrested last night.

Si urdhënoni Zotní, duket shumë i mërzitun dhe do me dijtë pse nuk u-lirue mbrâmë...

We have searched your clothes, wallet and briefcase. Why did you have secret papers concealed in your briefcase ?

Kishem marrë ca punë të zyres për në shtëpí, kështu që mos të kishem shumë punë nesër.

I understand that, but the papers that we found are not handled by you. Why were they in your briefcase ?

Më vjen keq, por do të jenë ngatrrue me shkresat e mija gabimisht.

You are lying ! These papers were taken out of the file yesterday when most of the personnel were taking a short break. Is that why you got permission to leave the office early ?

Nuk ju marr vesht se çka jeni tue thânë ! Dje mora leje mbassi më telefonuen se grueja ishte e sëmundë dhe desha t'ishem pranë saj...

Tell the truth ! You were under surveillance when you left. Why did you meet Riza Jonuzi ?

Riza Jonuzi âsht nji nga shokët e mij; po shkojshim me pí nji gotë së bashku.

Riza Jonuzi was interiewed this morning and he told us you have been selling him information. What's the reason you have done this ?

Humba të gjithë pasunín gjatë luftës së fundit dhe kishem nevojë për mâ shumë të holla për të mbajtë familjen.

That's no excuse for betraying your country ! Who are the other men that you contact ?

Kam takue tre njerëz gjithësejt, dy prej të cilëve banojnë në periferí të qytetit.

You'll be interrogated until we have a complete story. Give us their names and addresses !

I vetmi që njof âsht Riza Jonuzi. Dy tjerëve nuk u a dij emnat por mund të ju dërgoj në vendin ku do të takohemi.

That is what we want to know ! When are you supposed to meet them next time ?

Sonte kam pjekje me njânin prej tyne. Zakonisht kur takohen me mue vijnë dy vetë.

Good, we will have some men to surround the place. You'll endanger yourself if you try to tip them off. At what time are you going to meet them and where is the exact place ?

Do të takoheshim mbassi t'erret. Mund të ju a tregoj vendin në nji hartë mbasi e ndërrojmë përherë për mos të shkaktue dyshim.

What's your name and rank and serial number ?

Më quejnë Shaban Beqiri; jam rreshter dhe kam si numër ushtarak numrin MK-1267.

I see you are wounded. Do you need help ?

Asht tue më dhimbtë shumë. Ushtarët e tú më plagosën në kofshë, përndryshe nuk do t'isha dorëzue.

Call the doctor for this man. Do you care for a cigarette ?

Të falem nderit. Më kishin thânë se po të dorëzoheshem do të më vritshi. Nuk pritshem që të sillesh kaq mirë me mue.

Now, will you tell me from what unit you are ?

Je sjellë shumë mirë me mue; mâ mirë se eprorët e mij. Jam prej Kompanís së 29të. Kemi ruejtë urën e bekurmâës në Filat.

How many anti-aircraft weapons are there there ?

Nuk e dij. Unë kam bâ pjesë në grupin e patrullës.

Where is the HQ's of your unit located ?

Në shtëpín e kryetarit të bashkís. Ai u-detyrue të dilte nga shtëpija dhe tash banon gjetiu.

In what field are the troops concentrated ?

Trupat janë të përqëndrueme pranë hotelit që âsht pothuej nji gjymës kilometri poshtë lumit nga ura.

How many guardsmen are there in your unit ?

Çdo patrullë ka gjashtë njerëz dhe njizetekatër janë në rezervë përherë. Kemi gjashtë patrulla në ditë.

At what time is the patrol changed ?

Patrulla ndërrohet çdo 4 orë. N'orën 1 mbasdreke, mandej në 5 mbasdreke etj.

Who commands your group and what is his name ?

Komandanti i Grupit âsht kolonel Vangjel Staka. Si ai, ashtu të gjithë oficerat tjerë të Divizionit tonë mâ parë kanë qenë me mjetet e korracueme.

Thank you for your cooperation.

S'ka përse.

I'm wounded. Is there a doctor near here ?

Po, këtu afër banon nji mjek, pothuej nji gjymës kilometri n'at drejtim.

I'm very thirsty; do you have a drop of water to give me ?

Po shkoj të mbush nji kovë ujë në pus dhe po t'a sjell menjiherë.

Are there American soldiers nearby ?

Nuk e dij, unë s'kam pá ndonji.

Have you seen the enemy soldiers that passed thru this forest ?

Po, por s'i kam pá ç'prej dje.

I can't walk, how can I travel ?

Do të sjell nji shok dhe nji vig. Do të të bajmë na deri në shtëpí të mjekut.

Really ? Thank you very much. You are truly a good man. I won't forget this favor ever.

Me nderë qofsh. Na luftojmë në të njajtën anë. Kur të ndihmoj ty âsht si t'i ndihmoj vetes.

After the doctor will treat me do you have any place where I can hide ?

Mos u-bân marak ! Dij nji vend jo larg këndej, âsht nji magaze e vjetër. Anmiku nuk do të mendojë të shikojë aty.

Please hurry; my wound is hurting me.

Më vjen keq, por do të jetë mâ mirë të presim deri sa të prendojë dielli.

I'm convinced that you know best what I should do.

Kij durim edhe pak.

. . . . . .

. . . . . .

Is this the warehouse about which you were speaking ?

Po; bân pak të ftofët aty, por do të të sjell ca bataní.

Bring me also something to eat,please, if it is possible.

Do të mundohem të gjejë ndonji gjâ. Si âsht plaga tash ?

I have lost a little more blood but it doesn't hurt much.

Mirë. Duhet të rrijsh i qetë se përndryshe do të fillojë të rrjedhi gjak.

I should notify my regiment. Do you know a way how to notify them ?

Mbas pak ditësh do të mund të udhëtojmë. Duhet të presim pak ditë, s'kemi ç'të bâjmë.

You know best what to do. While we wait, do you care for a cigarette ?

Të falem nderit. Urdhëno shkrepsën !

I have longed for a cigarette but I was afraid to smoke when I was hidden in the woods.

E dij edhe unë. Po më pëlqen shumë kjo cingare. Asht e para herë për mue që pij nji cingare amerikane.

I have more. Take that package.

Të falem nderit shumë.

You are welcome. You have helped me a great deal. I won't forget this favor. If you had not come in time I could have died.

Fati e deshi që të kalojshem andej ! Gëzohem që pata rasë të të ndihmoj.

. . . . . .

. . . . . .

I'm glad that you came. I see you have brought the blankets. I was a little cold last night.

Po, por kam vetëm dy.

Please sit down; let's talk a little.

Mirë, kemi mjaft kohë.

Where do you live ?

Jetoj në nji fermë jo larg prej këndej. Po ti ku banon në Shtetet e Bashkueme ?

I live in a state called Tennessee.

Çfarë vendi âsht ?

It has many high mountains with large forests and small and large rivers.

Duket se qenka vend i bukur !

Yes, it is. To tell the truth I have a longing to see it again.

Të besoj. Çdo njeri dishron të jetë në shtëpín e tij.

Do you have a family ?

Po, kam nji motër dhe dy nipa. Burri i motrës ka vdekë dhe tash punoj në fermën e saj.

I'm sorry for your sister but it is good she has someone to help her.

Po, ashtu âsht si për 'të ashtu edhe për mue. Po ti ?

I had a store where I sold furniture. I'm married and I have a daughter.

Më duket se qenke i pasun !

No, but I have enough for my family.

A jeton familja jote ende në Tennessee ?

Yes, they are waiting for me there until I return.

Qofshin shëndosh. Tash duhet të më falish se më duhet me shkue.

I'll be seeing you.

Tungjatjeta.

. . . . . .

. . . . . .

Good morning, my friend !

Mirë mëngjes ! Si âsht plaga sot ?

Much better than yesterday. You thinkwe can leave today ?

Po. Kam sjellë dy kuaj me vete. Jam gati të nisem.

Good. Is it a long trip ?

Rruga që duhet të marrim âsht nëpër male e pyje. Do t'udhëtojmë pothuaj njizet orë. Shpresoj të mrrijmë nesër në mëngjes.

I'm ready to go !

Po të lodhesh më thuej se ndalemi me u-shlodhë.

How is the weather ?

Bân pak të ftofët por dielli do të dali shpejt e do të ngrofet koha.

Everything will be OK if we don't meet any enemy patrols.

Ashtu âsht. Kjo âsht arsyeja që do të shkojmë nëpër male. Ajo rrugë nuk rrifet aqë shumë.

What's in this bag ?

Në kët torbë kam nji palë dylbí dhe nji matara me ujë.

Shall I take the blankets ?

Po. Ti hyp në kët kalë e mbulohu me batanit; unë kam për vete nji gunë mbi kalë.

33

Good morning, Lieutenant.	Mirë mëngjes, Zotní Major.
I have come to make an investigation about the fire you had last night.	Dishroni me shikue vendin ?
Fine, let's go.	Si urdhënoni, Zotní Major.
What kind of a building was it ?	Ishte nji kazermë e vjetër. Qe ku âsht !
How many men lived here ?	Vetëm dyzet njerëz, nji togë.
Did the fire burn all the men's clothes ?	Jo, Zotní, ca plaçka u hodhën jashtë nga dritoret.
How about furniture, did it (they) burn ?	Jo, dhetë krevatë dhe ca karriga i qitën përjashta.
Where did the fire begin ?	Në katin e dytë.
At what time did it begin ?	Pothuej n'orën 12.
Who discovered the fire ?	Nji rreshter që banonte në katin e dytë.
What did he do then ?	U a nxori gjumin të gjithëve dhe vrapoi në qendër për të lajmue zjarmfiksit me telefonin e zyrës.
How about the barracks, did it begin to burn soon ?	Po, drûni ishte shumë i thatë mbassi ndertesa ishte mjaft e vjetër.
Weren't there any tools in the barracks with which to extinguish the fire ?	Po, por nuk qenë të mjaftueshme. Zjarmi mori shumë shpejt.
I believe the barracks is completely damaged and it is necessary to build another one.	Po. Besoj se po.
Let's return to HQ's; I'll write a report.	Si urdhënoni, po të dishroni mund të ju ndihmoj.
What's the name of the Corporal who discovered the fire ?	Astrit Leskoviku.

We are from the Military Police and we want your cooperation. Don't be afraid, we are not going to harm you.

Unë s'dij gjâ. Unë jam furrtár dhe nuk merrem as me politikë as me çashtje ushtarake.

Do you know Sergeant Petrit Myftari ?

Po, e njof; blén bukë në furrën teme.

How much bread does he buy a day ?

Nuk e mbaj mend. E kam të shkrueme në tefter sepse ai paguen në fund të çdo mueji.

Do you know where he lives ?

Po, banon në Rrugën Gjirolam De Rada, Nr. 38.

How many children does he have by his second wife ? It appears that his first wife was killed by a bomb !

Nuk e dij me cilën grue i ka, por e dij se ka pesë fëmijë: dy çuna e nji goçë. Grueja e parë u-mbyt në liqê, gjashtë vjetë mâ parë.

Tell me, what happened that she drowned ? Is it true that she could not swim ?

Unë s'kam qenë aty, por thonë se ai e ka shtŷ. Zoti e di !

Have you any idea how they used to get along with one another ?

Ai pinte dhe gjithënji pi shumë. Shkon vonë në shtëpí dhe pret t'a gjejë gruen çue dhe po të ketë shkue me fjetë fillon t'a shajë e t'a rrafi.

Can we depend on this information ? Would you give it to us in writing ?

Fqijt e tyne më kanë thânë ç'ju thash mâ parë. Që ai pi, atë e di gjithëkush.

Does he owe you any money from previous months ?

Po, më ka 1238 lekë borxh. I a kam kërkue sa e sa herë, por më kot.

Why don't you take the matter to court ?

Eh, mor Zotní, sikur t'a dijshi sa njerëz më kanë borxh, kishi për t'u-çuditë. Nuk kam kohë të padis botën.

You have been most helpful. We thank you and if we need you, we'll come to see you again. Good bye !

Urdhënoni kur të doni. Tungjatjeta !

35

If I want to send a message to Dibra, what should I do ?

Po të duesh me dërgue ndonji lajm në Dibër duhet të merremi vesh me kryetarin e rezistencës n'Elbasan. Ai njef shumë njerëz besnikë që venë e vijnë nga Dibra.

Is there any danger that it might be intercepted on the way by the enemy ?

Nuk besoj të kapet rrugës, mbassi tue qenë fshatár nuk bje shumë në sy. Me gjithë atë mund të ngjajë dhe e kundërta.

What's the quickest means ?

Mjeti më i shpejtë, por më i rrezikshëm, do t'ishte tue udhëtue me autobus nga Elbasani në Peshkopí. Më i sigurti, por natyrisht më i ngadalshmi, âsht me shkue më kambë.

Which is the way that should be followed ?

Kjo rrugë bje nga malet e Çërmenikës prej nga zbritet drejt në Peshkopí.

How can I get in touch with the leader of the underground in Elbasan ?

Po të duesh me rá në kontakt me të mund t'a rregulloj unë, mbassi kushrinin e tij e kam mik.

Whose son is he ?

Më vjen keq por nuk mund të të thom as si quhet as se i biri i kujt âsht.

From whom do you get all this information ?

As unë nuk e dij se si i marr vesh !

How do they communicate the information to you ?

Nuk âsht nji punë shumë e vështirë. Kemi mënyrë të sigurta se si me u komunikue antarëvet lajmet e informatat e nevojëshme.

So you are sure that if I go to Elbasan to meet the underground leader I won't fall in some trap.

Mos u-bân marak ! Më lajmo 24 orë para se të nisesh kështu që të lajmoj Elbasanin për mrritjen tânde.

In that case I'll leave tomorrow afternoon.

Shumë mirë. Të qoftë udha e mbarë !

Hello !

Is Lieutenant Kodra there ?

I'm Captain Dhori.

Yes, it's me, Lieutenant. How is the weather over there ?

Here we are having wonderful weather. Listen please, Lieutenant ! You had better take notes ! Do you have paper and pencil there ?

About 5 kilometers from where your unit is located the enemy has begun to open trenches.

Yes, there is even more ! We know that the 96th and 169th divisions have left in that direction.

You will send four or five men disguised as villagers who will try to get informed about this matter.

They should remain there until we call them back. They should send the information with trustworthy people as often as they see it feasible !

Notify at once the Division HQ's so that they will take care of that.

As soon as you hear any news from them call me up.

Yes, I almost forgot ! Tell the informers to find out also if the 28th Armor Division is still in Shajë, OK ?

Hallo !

Po, këtu âsht. Kush jeni ju lutem ?

Hallo, Kapiten Dhori ? Si jeni Zotní Kapiten ?

S'ka mâ keq. Ka vetue e bumbullue gjithë natën e tash âsht tue rá shí.

Po, kam. Urdhënoni, jam gati.

Vërtetë ?

Çka doni të bâj ?

Si urdhënoni.

Mirë, por për këtë gjâ ka me na u-dashë me pasë shumë të holla. Këtu kemi aqë sa me jetue. A mund të na dërgoni sa mâ parë nja 2000 a 3000 lekë ?

Posa të mbarojmë së foluni do të nis nji lajmtár për në Komandën e Divizionit...

Si urdhënoni, Zotní Kapiten. Ka ndonji gjâ tjetër ?

Pa tjetër, Zotní Kapiten. Besoj të ju thërras përsëri mbasnesër mbasdreke. Tungjatjeta.

What's your name ?

Më quejnë Bashkim Gjata.

When and where were you born ?

Kam lé në Muzhaq t'Elbasanit me 17 Maj 1921.

What kind of a school system did you have before the communists took over ?

Kishin sistemin shkolluer francez e sviceran, me fjalë tjera sistemin europian.

If I remember correctly you used to have two years of preparatory school, five years of elementary and eight years of secondary school !

Po, ashtu âsht, Zotní. Shkolla e mesme ndahesh në katër vjetë gjimnaz e katër vjetë licé ase në pesë gjimnaz e tre licé.

Did you have any other kind of secondary schools besides the ones you mentioned ?

Po, kishim shkolla normale, teknike, bujqsore, tregtare e ushtarake.

Where did the Albanian girls and boys go for higher studies before the State University was established ?

Përjashta. Zakonisht n'universitetet e Italís, t'Austrís e të Francës. Kemi pasë studenta që shkojshin me studjue edhe në Gjermani, në Belgjikë, n'Anglí, në Shtetet e Bashkuame e gjetiu.

What about now, what kind of a school system do they have ?

Tash kanë sistemin e shkollavet ruse. Katër vjetë fillore ase shkollat shtatvjeçare, katër vjetë gjimnaz dhe universitetin. Ka gjithashtu edhe disa istituta të nalta.

Isn't there any other kind of secondary school besides the gymnasia ?

Po, natyrisht, ka edhe shkolla industriale, teknike, bujqsore (teknikume), ushtarake etj., pak a shumë si të mâparëshmet.

Do all the students that go to the university now attend the State University ?

Jo, nji numër i madh shkojnë edhe ndër universitetet e Rusís e të Republikavet Popullore.

When is a student able to enroll in a polytecnical (teknikum) school and when in one of the high institutes ?

Nji nxânës mund të hŷjë në nji nga teknikumet mbassi të mbarojë shkollën shtatvjeçare dhe në nji nga institutet e nalta mbassi të kryejë gjimnazin.

Thank you very much, Mr. Gjata.

S'ka përse.

What's the number of your ID card and what's your rank ?	Jam rreshter dhe numri i letërnjoftimit âsht mbi tê. Tetari aty e ka letërnjoftimin tem.
What unit did you belong to ?	Jam në Batalionin e 2të të Regjimentit të 5të të Divizionit të 17të të Mekanizuem.
What were you doing near our lines when we captured you ?	Kishem urdhën me vendosë mina antitanks e mina kundër njerëzve 300 m. para fortifikatavet tueja.
Who was the group leader ?	Unë ishem.
How many men did you command ?	Grupi përbâhesh prej 12 vetësh.
What was the reason you were ordered to place mines in front of our positions ?	Nuk e dij arsyen; mue më dhânë urdhën me e bâ këtë gjâ dhe askush nuk më tregoi arsyen.
When did the 17th Mechanized Division come to this sector of the front ?	Nji pjesë ka ardhë nja trí javë mâ parë, pjesa tjetër ndodhet në këtë zonë të frontit tash 10 ditë...
When did you come ?	Regjimenti i 5të ka ardhë me grupin e dytë 10 ditë mâ parë.
What sector of the front did your Regiment come from ?	Regjimenti i 5të, i 7të e i 8të nuk ishin në front. Na kemi qenë caktue me detyrë ndër mbrapavija.
What did you do in the rear lines ?	Ndihmojshim Divizionin e 14të të Xhenjos në ndreqjen e rrugëvet, t'uravet etj.
For how long did these three regiments work with the 14th Engineer Division ?	Kemi qenë tue punue n'at sektor të mbrapavijavet për nja 9 javë.
What division did you come to replace in the front ?	Nuk e dij. Si ju thash, kur erdha unë gjeta në front njisít e divizionit tonë që kishin ardhë dý javë para nesh.
Where is your Batalion HQ's located ?	Komanda e Batalionit gjindet në nji çadër pranë lumit.

Is there any building in this city which we can use for offices and for class-rooms ?

Po dij nji godinë që ka nja njizet e sa dhoma dhe nuk besoj të jetë e zânun.

Where is this building located ?

Gjindet në skaj të qytetit.

Does the bus go anywhere near there ?

Po, autobusi ndalet pothuej tridhetë hapa larg nga godina në Rrugën Mihal Grameno.

Is it a wooden building or of some other material ?

Godina âsht prej betoni dhe âsht ndërtue katër vjetë mâ parë.

How many floors does it have ?

Ka trí kate dhe podrum.

For what purpose has the building been used before ?

Gjatë luftës qeverija e ka përdorë si shkollë nate për punëtorët e mprojtjes.

Does the building have any suitable room for the showing of educational films ?

Po, ka nji dhomë që mund të zâjë nja 50 vetë dhe mund të përdoret për at qëllim.

Where can we find the owner of the building ?

Pronari i godinës âsht nji major në pension por banon jashtë qytetit.

What do we do then ?

Pronari përfaqësohet prej Zotní Avokat Drenovës. Mund të shkojmë e të flasim me avokatin.

How much rent do you think he will ask for it ?

Besoj se qiraja do të jetë rreth 15,000-17,000 lekë në muej.

Is it possible to rent it for a short period of time ?

Besoj se do të pranojë vetëm nji kontratë tre vjetësh.

Shall we go and speak with the Major's lawer ?

Asht nji mendim shumë i mirë; ai do të na api spiegime mâ t'imta se ato që ju dhash unë.

Take that chair and sit down, Sergeant. When did you find out that your Battle Group was about to leave the front ?

Dý ditë mâ parë Komandanti i Kompanís na lajmoi se së shpejti Grupi ynë i Luftimit do të largohesh nga fronti për t'u-riorganizue e për të pushue.

Do you know what unit will come to replace yours ?

Me sa kam ndigjue ky sektor i frontit do të lëshohet prandej nuk do të vijë njeri me na zâvendësue.

How far back is the new line of resistance going to be ?

Nuk e dij, por ndoshta do të tërhiqen nja 10-12 km. deri ke vargu i kodravet.

How many casualties did you have in your Battle Group during the offensive we launched last week ?

Kompanija jonë ka pasë 30% humbje dhe mbetëm vetëm me nji oficer. Nuk dij gjâ mbi kompanít tjera por mendoj se edhe ata do të kenë pasë humbje të rânda.

What were you supposed to do with all the ammunition and the other material that you had ?

Çdo automjet e çdo tanks në gjendje të mirë do të tërhiqesh me trupat; tjerët do të shkatrroheshin. Teprica e municionit që nuk do të mund të transportohesh do të hudhesh n'erë.

Who was to cover your retreat to the new line of resistance, the heavy artillery and the rocket launchers ?

Mos harroni se Aviacioni ynë Taktik âsht në gjendje me e djegë e me e shkatrrue këthough zonë.

Then your retreat will be covered by tactical air support !

Këtê nuk e dij por dij se Aviacioni Taktik âsht tue pritë me padurim tash dý javë që të hapi pak koha.

Did your Tactical Air get any new type of airplanes ?

Po. Disa njisí t'Aviacionit Taktik janë pajisë me aeroplana të rij reaktivë luftues-bombardues që shkojnë pothuej dý herë mâ shpejt se shpejtësija e zânit.

Where did you hear this news ?

Komandanti i Batalionit po u tregonte disa oficerave tjerë, trí ditë mâ parë, çka ju thash. Unë kalova rastësisht andej dhe e ndigjova.

41

Tell me Sergeant, how is the climate in Albania, generally speaking ?

Klima ndër krahina bregdetare ësht përgjithësisht e butë. Gjatë bregdetit pothuej kurr s'bje borë.

What about the rest of the country, how is the climate over there ?

Ndër krahinat që janë pak larg nga bregdeti gjatë dimnit bje borë e ngrin akull kurse vera ësht zakonisht e nxehët.

This climate goes for the highlands too, I guess !

Pak a shumë, por ndër zonat malore vera nuk ësht aq e nxehët kurse në dimën bje kaq shumë borë sa shpesh qëllon të zehen rrugët.

What kind of roads do you have in Albania ?

Kemi nji rrjetë rrugësh mjaft të mira. Këto rrugë lidhin të gjitha krahinat e Shqipnís me njána tjetrën.

It will be easy then to visit any region of the country. Are there many beautiful spots ?

Ka male të bukura që janë të mbulueme me borë dimën e verë. Ka liqénj, lumej e pyje madhështore. Nji nga këta liqénjt (ai i Pogradecit) ësht i famëshëm për këthjelltësín e ujit të tij.

There must be quite some places for a person to spend a vacation in some summer resort !

Ka vende verimi e vende klimaterike në të gjitha anët e Shqipnís,në Veri e në Jug e gjatë gjithë bregdetit.

Are there hotels and restaurants,let's say in some climatic center in the mountains of Northern Albania ?

Po, ka hotele ku mund të merrni nji dhomë me qirá dhe restauranta ku mund të hani me çmime t'arsyeshme.

Which is the most famous beach in Albania ?

Plazha e Durrsit ësht mâ e famëshmja qoftë sepse ka shumë hotele,restauranta e vende dëfrimi por edhe sepse këtu shkojnë me mija njerëzish nga Tirana për të verue e për pushime.

How far is the beach of Durrës from Tirana ?

Asht fare afër, 39 km. nga Tirana.

What's your name,rank and ID card number ?

Më quejnë Thoma Seresi dhe jam ushtár i thjeshtë. Numri i letërnjoftimit âsht 794-256.

What unit did you belong to ?

Ishem në Kompanín e 5të të Brigadës së 3të të Korparmatës së 6të.

What were your duties in the 5th Company ?

Ishem në Seksionin e Mirëmbajtjes së Mjetevet të Motorizueme. U-kujdesojshim që tanksat, topat vetëvizës, kamionat etj. t'ishin në gjendje të mirë.

What type of tanks did you mostly work on ?

Në Korparmatën e 6të kishte vetëm tanksa të mesëm dhe nji brigadë topash vetëvizës.

What kind of armament do your medium tanks have ?

Kanë nga nji top 90 mm., nga nji mitraloz 30 mm. e nga nji mitraloz 50 mm.

What's the effective range of the 90 mm. gun that is placed on the tank ?

Nuk e dij me sigurí por kur topi âsht i pajisun me shinjestër me teleskop besoj se ka nji rreze të përpikët prej 2600-2800 metrash.

What kinds of SP guns are there in the 6th Army Corps ?

Unë kam pá vetëm dy lloj topash: topin vetëvizës 100 mm. dhe topin vetëvizës 155 mm.

How many companies were there in your brigade ?

Brigada e 5të përbâhesh prej pesë kompanish dhe prej ty togash: nji togë sinjalizimi dhe nji togë në rezervë.

What kinds of weapons had the various companies ?

Kompanija e 1rë dhe e 2të përbâheshin prej pushkatarësh, Kompanija e 3të ishte e pajisun me mortaja 81 mm. dhe Kompanija e 4të me armë antitanks.

What about the 5th Company ?

Nji pjesë e Kompanís së 5të ishte caktue,si ju thash, me Seksionin e Mirëmbajtjes së Automjetevet, pjesa tjetër ja ishte në rezervë ja ndihmonte Kompanín e 3të të Mortajavet.

Questions on Military Subjects
Pyetje me karakter ushtarak

1.- Thoni emnat e gradavet të nënoficeravet t'ushtrís shqiptare.

2.- Thoni emnat e gradavet t'oficeravet t'ushtrís shqiptare.

3.- Sa kompaní ka zakonisht nji batalion ?

4.- Ç'gradë ka komandanti i nji d.vizioni ?

5.- Në cilën kompaní jeni ju ?

6.- Cila gradë vjen mbas majorit ?

7.- Si quhet njisija që âsht mâ e madhe se skuadra ?

8.- Kush jeton në nji kamp ushtarak ?

9.- A keni hŷ n'ushtrí si vullnetár apo si rekrut ?

10.- Si quhen ndërtesat ku flêjnë ushtarët ?

11.- Ç'gradë keni ?

12.- A keni shti ndonjiherë me mitraloz ?

13.- A kemi këtu ndonji nxânës që bân pjesë n'Aviacion ?

14.- Çfarë pushke kanë ushtarët e ushtrís shqiptare ?

15.- A bâni pjesë n'Artilerí ?

16.- Cila degë e ushtrís ka mâ shumë topa ?

17.- Cila âsht grada mâ e naltë e nji nënoficeri t'ushtrís shqiptare ?

18.- Ç'detyrë ka nji rojë ?

19.- A ka zyrë rekrutimi në Monterey ?

20.- A kemi në këtë klasë ndonji nxânës që bân pjesë në Marinë ?

21.- Ç'gradë ka komandanti i shkollës sonë ?

22.- Cila âsht grada mâ e naltë n'ushtrín shqiptare ?

23.- Ç'd.m.th. shqip "enemy soldiers" ?

24.- Ku e ka qendrën Divizioni i 5të ?

25.- Cila âsht njisija mâ e vogël e ushtrís ?

26.- Thoni gradat e oficeravet eprorë.

27.- A kemi ndonji oficer në këtë klasë ?

28.- Sa komandanta ka çdo togë ?

29.- Çfarë njisije komandon nji major ?

30.- Çka i zgjon ushtarët në mëngjes ?

31.- Sa kompaní ushtarësh ka në Presidio ?

32.- A keni udhëtue ndonjiherë me aeroplan ?

33.- A ka në Presidio ndonji armë antiajrore ?

34.- Thoni emnin e ndonji arme antitanks.

35.- A keni shti ndonjiherë me revolver automatik ?

36.- Çfarë ngjyre ka kapela e ushtarëvet t'Aviacionit ?

37.- Sa larg mund t'a hudhni nji bombë dore ?

38.- Sa fishekë zê nji çifte ?

39.- Sa peshon nji predhë për topa antitanks ?

40.- Çfarë armësh përdorin ushtarët e kambësorís ?

41.- Kur keni qenë në manevra herën e fundit ?

42.- A ka oficera të Marinës në këtë shkollë ?

43.- A përdorojnë mina ushtarët e kambësorís ?

44.- Sa larg mund t'a hudhi predhën nji mortajë ?

45.- Ku e ka qendrën shtabi i Divizionit të 12të ?

46.- Zakonisht, sa topa ka nji tanks ?

47.- Sa nalt mund të shkojë nji aeroplan ?

48.- Thoni emnat e armëvet që dini ?

49.- Thoni emnat e degëvet të ndryshme të Fuqivet t'Armatosuna.

50.- Sa aeroplana besoni se ka Aviacioni i Shtetevet të Bashkueme ?

51.- Ç'gradë do të keni kur të dilni nga ushtrija ?

52.- Sa peshon nji bombë dore ?

53.- Sa ushtarë flêjnë në nji kazermë në Presidio ?

54.- Ç'gradë vjen përpara kapitenit të klasës së parë ?

55.- Sa fishekë mund të zbrazi në minut nji mitraloz i lehtë ?

56.- Çfarë njisije komandon nji nënoficer ?

57.- Sa vjetë duhet të rrijë n'ushtrí nji rekrut ?

58.- Krye sa orësh ndërrohet nji rojë, zakonisht ?

59.- Cilat degë të Fuqivet t'Armatosuna kanë shtabe ?

60.- Sa vjetë do të rrini në rezervë mbassi të dilni në lirim ?

61.- Sa mitraloza ka nji tanks i lehtë ?

62.- Kur do të gradoheni ?

63.- Cila âsht grada mâ e ulët e oficeravet t'ushtrís shqiptare ?

64.- A kanë mâ ushtrít njisí kalorije ?

65.- Çfarë plaçkash mbahen në nji magazinë ?

66.- Sa fishekë zê nji revolver automatik ?

67.- A ka armë antiajrore automatike ?

68.- Sa kilometra n'orë mund të shkojë nji tanks ?

69.- Thoni emnat e disa armëve automatike.

70.- Sa vjetë shërbim i duhen nji togeri me u-gradue kapiten ?

71.- Sa mund të peshojë nji bombë aeroplani ?

72.- Ç'gradë ka komandanti i Fort Ord-it ?

73.- Sa nënoficera ka nji togë ?

74.- Sa mitraloza ka nji togë kambësorije ?

75.- Sa lloj kapitenash ka ushtrija shqiptare ?

76.- Me se merren ushtarët e Intendencës ?

77.- Ku flêjnë trupat kur shkojnë për fushim ?

78.- Sa bomba dore ka nji ushtár që âsht gati për sulm ?

79.- Në rasë lufte cilët merren ushtarë ?

80.- Sa njerëz zê nji tanks ?

81.- A dini me i rá burís ?

82.- Ku gjindet qendra e rekrutimit të gadishullit të Monterey-t ?

83.- Kush âsht komandanti i përgjithëshëm i Fuqivet t'Armatosuna të Shtetevet të Bashkueme t'Amerikës ?

84.- Sa kazerma ka në Presidio ?

85.- Cili shtje mâ larg: nji top apo nji mitraloz antiajruer ?

86.- Sa fishekë zê nji pushkë M-1 ?

87.- Cila âsht dega mâ e madhe e ushtrís ?

88.- Sa skuadra ka zakonisht nji togë ?

89.- Cila âsht grada mâ e ulët e ushtrís shqiptare ?

90.- Ç'gradë ka kryetari i nji skuadre ?

91.- Cila âsht dega mâ e madhe e Fuqivet t'Armatosuna ?

92.- Sa peshon, afërsisht, nji mitraloz i rândë ?

93.- Sa magazina ka në Presidio ?

94.- A ka ndonji shkollë të Marinës në Monterey ?

95.- Çfarë çizmesh kanë pjesëtarët e Fuqivet t'Armatosuna të Shqipnís ?

96.- Sa bataliona ka zakonisht nji regjiment ?

97.- Cila gradë vjen mbas kapterit ?

98.- Sa brigada ka zakonisht nji divizion ?

99.- Sa divizione ka zakonisht nji korparmatë ?

100.- Sa mitraloza ka nji aeroplan luftues-bombardues ?

101.- A ka ushtrija shqiptare njisí kalorije ?

102.- Sa milë (kilometra) mund t'eci nji ushtár në 24 orë ?

103.- A mund të gradohet nji nënoficer e të bâhet oficer ?

104.- Për sa muej rri nji aspirant me at gradë ?

105.- Prej sa vetësh përbâhet zakonisht nji patrullë ?

106.- Sa lloj tanksash ka ushtrija shqiptare ?

107.- Çfarë armësh përdorin ushtarët në sulm ?

108.- Sa njerëz duhen për të bajtë nji mortajë ?

109.- Ku vêhen minat, zakonisht ?

110.- A bâjnë shpesh manevra në Fort Ord ?

111.- Me çfarë armësh janë të pajisun ushtarët e Artilerís ?

112.- Sa larg e hudh predhën nji top antitanks ?

113.- Sa fishekë ka me vete nji ushtár, zakonisht ?

114.- A ka aeroplana t'armatosun me topa automatikë ?

115.- Çfarë arme bajnë me vete policët ?

116.- A keni bâ ndonjiherë rojë natën ?

117.- Cila degë e ushtrís âsht mâ e madhe: kambësorija apo xhenjoja ?

118.- Sa âsht i gjatë nji top antitanks ?

119.- Si quhet njisija mâ e madhe e ushtrís ?

120.- Çfarë armësh përdoron artilerija ?

121.- Prej sa korparmatash përbâhet zakonisht nji armatë ?

122.- Sa nënoficera ka nji batalion ?

123.- A ka në qytet ndonji magazinë ushtarake ?

124.- A veshin çizme pjesëtarët e Fuqivet t'Armatosuna të Sh.B.A. ?

125.- Me çfarë vegle mund t'orientohet nji ushtár ?

126.- Kur filloi lufta e dytë botënore ?

127.- Si quhet vendi ku mbahen armët ?

128.- Ç'gradë mund të ketë nji graduat ?

129.- Po të doni me dalë nga Presidio-ja, a keni nevojë për lejekalim ?

130.- Ku i keni bâ stërvitjet e para ushtarake ?

131.- Çka mbajmë zakonisht në nji matara ?

132.- Me çfarë aparati merren vesh njisít e ndryshme t'ushtrís ?

133.- A dini me gradue nji mortajë ?

134.- A keni ndonji shok që gjatë luftës ka qenë në front ?

135.- Sa graduatë ka gjithësejt në kursin e gjuhës shqipe ?

136.- A keni qëndrue ndonjiherë në formacion ushtarak ?

137.- Kur mbaroi lufta e dytë botënore ?

138.- Sa kohë ngjasin stërvitjet e para ushtarake ?

139.- A keni pá ndonjiherë aeroplana tue fluturue në formacion ?

140.- Në rasë mobilizimi të përgjithëshëm, sa divizione mund të ketë Shqipnija ?

141.- Kur bje burija, zakonisht ?

142.- Sa lloj bombash dore ka ?

143.- Kurë ju kanë marrë nën armë ?

144.- Në rasë lufte, sa kohë rrin nji ushtár në front, zakonisht ?

145.- Prej sa pjesësh përbahet nji mortajë ?

146.- Sa larg mund të shtjerë nji revolver ?

147.- Sa predha në minut mund të zbrazi nji top automatik ?

148.- Në ç'vjet filloi lufta e parë botënore ?

149.- A marrin pjesë ndër manevra oficerat eprorë ?

150.- Ç'gradë duhet të ketë nji komandant kompanije ?

151.- Ç'lloj armësh kanë ushtarët që shkojnë në patrullë ?

152.- Çka mbajmë në nji depo, zakonisht ?

153.- Çka i duhet busola nji ushtari ?

154.- Në ç'vjet filloi lufta e Korés ?

155.- A keni pá ndonjiherë nji top antiajruer ?

156.- Thoni emnat e disa armëve automatike ?

157.- A dini me përdorue nji busolë ?

158.- Thoni emnat e disa njisive ushtarake.

159.- Sa topa ka nji baterí artilerije ?

160.- Sa larg mund të shtjerë nji pushkë ?

161.- A keni në këtë klasë ndonji nxânës që bân pjesë n'Artilerí ?

50

162.- Sa nënoficera ka në kursin e gjuhës shqipe ?

163.- Gjatë luftës së Korés, a shpalli Amerika mobilizim të përgjithëshëm ?

164.- A mund të gradoheni tue qenë në rezervë ?

165.- Në rasë lufte, kush dërgohet në front ?

166.- A ka ushtrija amerikane aspiranta ?

167.- Në këtë shkollë, a bâjnë nxânsit rojë ndonjiherë ?

168.- Sa topa të vjetër ka në Presidio ?

169.- Prej sa togash përbâhet zakonisht nji kompaní ?

170.- A di çdo ushtár me gradue nji top antiajruer ?

171.- A keni shti me bazukë ndonjiherë ?

172.- Me se merret Ministrija e Mprojtjes Kombëtare ?

173.- Po të doni me shkue në Meksik, a keni nevojë për lejekalim ?

174.- A mund të qitet në pension nji major me gradën nënkolonel ?

175.- Nji nënoficer, a mund të jetë njikohësisht oficer në rezervë ?

176.- A keni hŷ mbrenda nji tanksi ndonjiherë ?

177.- Kush i ruen depot e armëvet ?

178.- A keni bajtë revolver ndonjiherë ?

179.- Sa kampe ushtarake ka në Kaliforní ?

180.- Ç'gradë ka komandanti i kompanís suej ?

181.- A mund të bahet nga nji ushtár nji mitraloz i rândë ?

182.- Me se merren ushtarët e Xhenjos ?

183.- Sa vjetë duhet të rrijë nji ushtarë që ka hŷ vullnetár në Marinë (Aviacion) ?

184.- Me se mund të transportohet nji top ?

185.- Sa mortaja mund të ketë nji kompaní kambësorije ?

186.- Sa pasagjerë mund të zâjë nji aeroplan reaktiv ?

187.- Sa lufta botënore ka pasë deri tash ?

188.- Për se na nevojitet radioja ?

189.- Ç'gradë vjen mbas tetarit ?

190.- Cilët quhen graduatë ?

191.- Cilat plaçka konsiderohen pajimə ?

192.- Çka âsht bajoneta ?

193.- A ka ushtrija aeroplana ?

194.- Ç'moshë duhet të keni për të hŷ n'ushtrí ?

195.- Sa fishekë zê pushka e ré M-15 ?

195.- Pse rrijnë ushtarët ndër llogore ?

196.- Në luftë, pse mbajnë ushtarët helmetë ?

197.- A janë të pajisun të gjithë ushtarët me pushkë granatë-hudhse gjatë nji beteje ?

198.- A kanë të gjitha armët shinjestër ?

199.- Në cilën degë të Fuqivet t'Armatosuna bâjnë pjesë mjetet e korracueme ?

200.- Cilët veshin uniformë: civilat apo ushtarakët ?

Military Word List
(English-Albanian)

Listë Termash Ushtarakë
(Inglisht-Shqip)

A A gun	top kundërajruer
accountability	intendencë
activate	aktivizoj, vë në veprim
adjutant	adjutant
advance	përparoj, përparim
advance guard	pararojë, rojë e përparueme
aerial photograph	fotografí ajrore
aerial supply	furnizime ajrore, furnizime nga ajri
aggressor	sulmues, agresor
aid man	infermier
aid station	infermerí
aiming point	nishan, shêj
air base	bazë ajrore
airborn	i transportuem me mjete ajrore (me aeroplan a helikopter)
airburst	plasje e nji predhe n'ajr
aircraft carrier	ajrorëmbajtse, aeroplan bajtse
air defense	mprojtje ajrore ase kundër-ajrore
air force	flotë ajrore (usht.), aviacion (usht.)
airhead	vend ku furnizimet sillen me anë të mjeteve ajrore
airlift	transportim ajruer
airplane	aeroplan

air raid	bombardim ajruer
air strip	pistë
air support	ndihmë ajrore
air transportation	transportim ajruer
air warning net	sistem radiostacionesh për të dhânë kushtrim antiajruer
all-around defense	mprojtje e përgjithëshme
allocation	kredí për blemje furnizimesh së ndryshme
ammunition supply point	qendër furnizimi të municionit
ammunition train	tren municioni
amphibious	mjete amfibe
antenna	antenë
anti-aircraft gun	top antiajruer
antipersonnel mine	minë kundër njerëzve
antitank defense	mprojtje kundër tanksave
approach march	përparimi e nji njisije luftuese kur përleshja e drejtpërdrejtë me armikun âsht e paevitueshme
arm and hand signals	sinjale me krahë e me duer
armored	i koracuem
armor-piercing	që shpon koracën
arms	armë
army	armatë; ushtrí
army group	grup armatash nën nji komandë

arrest	arrestim, rreshtim
arsenal	depo armësh, arsenal
artillery (heavy) (medium) (light)	artilerí (e rândë) (e mesme) (e lehtë)
assault fire	zjarm për sulm
assault position	pozicion sulmi
assault wire	tel telefoni shumë i hollë që baret në shpinë dhe përdoret prej trupavet në front
assembly	mbledhje; sinjali që epet nga borizani për t'u-mbledhë njisít e ndryshme sëbashku; grupim njisísh njâna afër 'jetrës; grumbullim pjesësh, veglash ase armësh
assembly area	vend mbledhje (për pregatitje)
atomic	atomik
attach	përngjis, atashoj
attack	sulm, mësyemje
attack position	pozicion sulmi
authentication	autenticitet
authenticator	autentikues
automatic	automatik
automatic gun (weapon)	armë automatike
avenues of approach	mënyrë ase rrugë afrimi
axis (evacuation) (communications) (supply)	udhë (zbrazje) (komunikacioni) (furnizimesh)
badge	shêj dallues, distinktiv

bank	breg
barrage	batare
barrel	tytë
barrier	pengesë ase grup pengesash
base of fire	baza e zjarrit a e qitjes
basic load	sasí municioni bazë
battalion	batalion
battery	baterí
battle	betejë, luftim
battleship	anije lufte, luftanije
bazooka (see rocket launcher)	predhë hudhëse, bazukë
beach	plazhë, ranishtë, bregdét
beachhead	kryeurë në bregdét
beachmaster	oficeri i ngarkuem me detyrën e nji zbarkimi amfib, komandanti i fuqive të zbarkueme në bregdét
bedding roll	shtresë e mbulesë, cule
belt (terrain)	rryp toke (zak. paralel me frontin)
bench mark	pikë goniometrike
biological agent	mjet biologjik
bivouac	fushim
blackout	errësim
blast area	toka e zharitun përreth grykës së nji topi
boat (landing, assault)	barkë, sandall (zbarkimi, mësymje

bomb	bombë
bombardment	bombardim
bomber	bombardues
bombing	bombardim ajruer
booby trap	grackë (kundër njerzish)
boundary	kufi (vijë që cakton gjânësín dhe thellësín e zonës së veprimit ase të vendit a të sektorëvet të mprojtjes)
bracket (artillery fire)	largësija në mes dy predhash (vendi ku plasin)
branch (arm or service)	degë (ushtarake)
breakthrough	depërtim, çamje e frontit
breech (breechlock)	shul
brevity code	shifër
bridge (floating)	urë (mbi barka)
bridgehead	kryeurë
brigade	brigadë
build-up	formim
bullet	plumb, predhë
bunker	fortifikatë
burial party	njerzit që marrin pjesë në vorrim; personel ushtarak i ngarkuem me mbledhë të vdekunit e të plagosunit mbassi të mbarojë luftimi
burst	plasje, plas
butt	tunë, kondak

by pass	me i dalë anmikut anash pa u-ndeshë me 'të
cable	kabllo, tërkuzë
caliber	kalibër
call sign	grup germash ase numrash që përdorojnë radiostacionet për t'u-identifikue
camouflage	maskim
campaign	fushatë; luftë me anmikun në nji vend të caktuem dhe mbrenda datash së caktueme
canalize	me pengue përparimin e anmikut me anë pengesash e qitjesh në nji zonë sa më të ngushtë
cannibalize	me zâvendsue pjesë maqinash së prishuna prej nji maqine tjetër
canister	pjesa e maskës kundër gazevet ku gjinden lândët kimike për filtrimin e gazevet helmuese; predhë topi që përmban copa të rrumbullakta hekuri
cannon	top
canteen	matara, pagúr
captain	kapiten
capture	zâ, kap, zânie, kapje
carbine	pushkë e shkurtë automatike
cargo	ngarkesë (armë, municion, automjete, ushqime, etj.)
carriage (gun)	pjesa ku mbështetet arma
carrier	kamion ushtarak

cartridge	fishek
cartridge belt	rryp fishekësh
casualties	humbje në njerëz
cavalry	kalorí
censorship	censurim
certificate	certifikatë
chain of command	oficera eprorë që apin urdhëna
channel	hierarkik
check point	vend kontrollimi, postblok
chemical	kimik
chemical corps	trupa kimikësh
chemical warfare	luftë kimike
chief of staff	kryetari i shtabmadhorís
circuit	qark elektrik
classification	klasifikim
classify	klasifikoj (me konsiderue nji gjâ si të fshehtë)
clear	kontrollim që arma të jetë pa gjâ mbrendë; dërgimi i nji shkrese pa shifra
clearance	shkresë me të cilën i epet leje nji anije, nji njisije etj. me udhëtue nga nji vend në nji tjetër; autorizim për të punue në çashtje sekrete; në rregull
clearing station	infermerí fushore; qendër kontrollimi

clip (cartridge)	krahën fishekësh, karikator
close combat	luftim nga afër
code	shifër
collection point	vend grumbullimi, vend mbledhje të plagosunish, etj.
colonel	kolonel
column	kolonë (formacioni i trupavet, i tanksavet e mjetesh tjera lufte njâni mbas tjetrit)
combat command	njisí e madhe taktike (për betejë)
combat outpost	pararojë
combat vehicle	automjet i koracuem ase jo prej nga ushtarët luftojnë
command net	rjetë ndërlidhëse radiotelegrafike (me anë së cilës u epen urdhëna njisive të ndryshme)
command post	komanda e shtabit të nji njisije, komandë shtabi
commander	komandant
commissary	dyqan gjânash ushqimi për ushtrí
communication(s)	komunikim, ndërlidhje ushtarake, komunikacione
communication(s) center	qendër komunikacionesh, qendër ndërlidhje ushtarake
company	kompaní
compass (magnetic)	busolë
complement	kuadri i plotë i nji njisije

component	degët e ndryshme që përbâjnë nji ushtrí
concealment	fshehje, maskim
concentration	përqëndrim
concertina (wire entanglement)	tela me gjemba në formë spirale
contact	kontakt, lidhje ndërmjet njisísh
contain (to hold)	përmbaj (ndaloj forcat anmike)
contaminated area	zonë e infektueme
control	kontrollim, kontroll; autoriteti që ushtron nji komandant mbrenda nji njisije
convoy	karvan(ushtarak ase detár)
coordinated fire plan	plan taktik zjarmi të bashkërenduem
coordinate	bashkërendoj, koordinoj
corporal	rreshter
corps	korparmatë, trup (ushtarak)
corridor (terrain)	koridor, rryp tereni; udhë ajrore që u caktohet aeroplanavet miq që mos të gjuhen nga artilerija kundërajrore
counterattack	kundërsulm
counterbattery	kundërveprim baterije kundër artileris anmike
counterreconnaissance	kundërvezhgim
countersign	kundërparullë
courier	lajmtár, korier

court-martial	gjyq ushtarak
cover	mprojtje, strehim, mprohem
coverage	mprojtje; zonë ushtarake e fotografueme nga ajri; strehim
covering force	trupa mprojtse që shkojnë përpara
crash	rrëzim, shkatrrim
crew-served weapon	armë që për përdorimin e tyne duhet më shumë se nji njeri
critique	shoshitje veprimesh ushtarake për t'evitue gabime
crossfire	kryqzim zjarmi a qitjesh
cruiser	kryqzuer
deadline (suspense date)	afat, mbarim afati, me nxjerrë jashtë shërbimi për ndreqje
dead space (area not covered by fire)	zonë mbrenda rrezes së nji arme që nuk mund të qëllohet për arsyena të ndryshme
debarkation	zbarkim
deception	mashtrim, diversion
declassify	mos me e konsiderue më nji gjâ si të fshehët
decode	deshifroj
decontaminate	dezinfektoj
defend	mproj
defense	mprojtje
defensive position	pozicion mprojtje

defilade	pengesa natyrale për mprojtje
delaying action	veprim për të vonue përparimin e anmikut
demilitarization	çmilitarizim
demobilization	çmobilizim; me nxjerrë jashtë përdorimi armë atj. që të mos përdoren nga anmiku
demolition	rrenim, shkatrrim
deploy	me zgjânue frontin
depot	depo; qendër zâvendsimi ushtarësh
depth	thellësi (fronti, llogorje)
depth charge	bomba ase eksploziva tjerë që përdoren për plasje n'ujë
desert	dezertim, dezertoj
detached	jo i caktuem me ndonji detyrë; njisí që shërben në nji njisí tjetër por nuk âsht në kuadrin e saj; i damë
detachment	detashment
discipline	disiplinë
disengage	ndërpres luftimin
disperse	me shpërdá
displace	me ndërrue pozicion (në luftim e sipër)
distribution	shpërndamje trupash, damje trupash
division	divizion
draw	luginë, greminë, humnerë

drop zone	vendi ku hudhen parashutistat ase furnizimet e materialet
dry storage	magazinë, depo e mbulueme nga të gjitha anët
dud	predhë që s'ka plasë
dugout	llogore nën dhé, strehim
dump (supply)	depo e përkohëshme furnizimesh
echelon	mënyra e të renduemit të trupavet në front; shkallëzimi i njisivet ushtarake; nivel, shkallë, rang
element	element, pjesë njisije
elevation	naltësi, kandi i qitjes
embark	ngarkohem në nji anije
emblem	dekoratë, nishan; stemë
embrasure	frangjí, mazgall
emplacement	vend i pregatitun për topa të rândë
encirclement	rrethim, të rrethuemit
encode	shifroj, shkruej me shifra, shifrar
enemy	anmik
enfilade	zjarm për të përfshí gjatësín e frontit anmik
engagement	përleshje në mes dy forcash anmike, betejë
engineer (combat)	xhenjo, ushtár i xhenjos
enlist	hŷj n'ushtrí vullnetarisht

65

entrench (intrench)	me bâ llogore, me pajisë me llogore, me fortifikue
entruck	me ngarkue ushtarë në kamion
envelop	me mësy anmikun anash e njikohësisht edhe përballë
envelopment	sulm kundër anmikut anash e njikohësisht edhe përballë
equipment	pajisje e furnizime
escort	rojë; rojë nderi; njisí mprojtse
estimate of the situation	shqyrtim i gjendjes dhe i të gjitha problemeve ushtarake
executive officer	oficer ekzekutiv
exploitation	shfrytzim, përfitim
explosive	eksploziv
exposed	i pamprojtun
fatigue (labor detail)	ushtarë që bâjnë punë krahu (jo ushtarake)
feint	sulm jo i vërtetë, sulm për të mashtrue anmikun
field artillery	artilerí fushore
field of fire	vend qitjesh
field telegraph	telegraf fushuer
field telephone	telefon fushuer
field wire	tel telefoni i butë
fighter (aviation)	aeroplan luftues
fighter cover	aeroplan luftues-mprojtës

final protective fire	zjarm i përqëndruem afër nji pozicioni mprojtës
fire adjustment	rregullim qitje, të rregulluemit e qitjeve
fire and maneuver	shtimje e manovrim, metodë mësyemje me elemente të mprojtuna nga zjarmi i elementevet tjera
fire control	pregatitje qitjesh; të pasunit nën kontroll qitjet
fire discipline	zotsí e disiplinë e personelit ushtarak në qitje, disiplinë në qitje
fire distribution	qitje efektive
fire plan	plan taktik qitjesh
fire superiority	superioritet në qitje
first aid	mjekim provizor (para se të dërgohet ushtaraku në spital)
first sergeant	kapter i klasës së parë
flame thrower	flakëhudhëse
flank (right and left)	anë, krah (i djathtë dhe i majtë)
flare	fishekzár për sinjale ushtarake, raketë
fleet	flotë, flotë detare
flexibility	lehtësí në lëvizje
flight	fluturim, udhëtim me aeroplan
follow up	mos me i u-dá anmikut në tërheqje; me hetue sasín e furnizimevet

formation	formacion
fortification	fortifikim, fortifikatë
fortify	me fortifikue
forward observer	vëzhgues që rri përpara
foxhole	gropë (në të cilën mund të rrijë një ushtár)
frequency	frekuencë, vibracion
front	front, ballë lufte
frontal attack	sulm frontal
fuze	sigurecë, fitil
garrison	garnizon
gas (chemical)	gaz (kimik)
gas mask	maskë kundër gazit
general officer	gjeneral
general outpost	pararojë e përgjithëshme
graves registration	organizatë ushtarake që merret me identifikimin e të vdekunvet dhe me mirëmbajtjen e vorrezavet
grazing fire	qitje ku predhat nuk shkojnë mâ nalt se gjatësija e njeriut me qëllim që të paralizohen lëvizjet e armikut
grenade (hand) (rifle)	granatë dore granatë që hudhet me pushkë
grid line	koordinatë, vijë vertikale ase horizontale mbi një hartë
group	grup; njisí administrative e taktike e përbâme prej dy ase mâ shumë batalionash; shumë armata nën një komandë

guard	rojë
guerilla	guerilje, çetë
gun	top, armë zjarmi
gunner	artiljer, topçi
gun tube	grykë topi, tyta e topit
handset	telefon ushtarak
harassing fire	qitje kundër armikut për mos t'a lânë të qetë, qitje jo intensive
hasty defense	mprojtje e organizueme për ngut në luftim e sipër
headquarters	shtab, komandë
headset (headphones)	kufje e mikrofon që vêhen në krye
hedgehog	pengesë trekamëshe me tela me gjemba (që mund të baret)
helicopter	helikopter
helmet	helmetë
high explosive (HE artillery term)	eksploziv i fuqishëm
holding attack	sulm me qëllim me e mbajtë armikun në pozicionet që ka
hospital	spital
howitzer	lloj topi (howitzer)
icing (conditions)	e ngrime, ka akull, akull
identification	identifikim
immobilize	me ngujue, me ndalue
inactivate	me suprimue

incendiary (bomb)	bombë ndezëse, bombë djegëse
individual weapons	armë vetiake
infantry	kambësorí
infiltrate	me depërtue, me u-futë
initial point	pikënisje; pikë bashkimi; objektiv
inspection	inspektim
installation	qendër ushtarake, bazë ushtarake (me kazerma,spitale,etj.)
insubordination	mosbindje urdhëni epruer
intelligence	mbledhje informatash, studimi i informatavet të mbledhuna për sa i takon zonavet anmike tue përfshi kohën, terenin, etj.
interception	luftim kundër anmikut për t'a pengue e ndalue në kryemjen e misionit të tij
intercept station	radiostacion që ndigjon radion e anmikut për të mbledhë informata
interdict	me pengue anmikun me artilerí ase me mjete kimike që të kalojë nëpër nji zonë a rrugë
interference	.ëërhymje; trazim që i bâhet nji radiostacioni
in the clear (uncoded)	jo e shifrueme, jo me shifra
joint operations	operacione të përbashkëta (zakonisht nga ushtrija dhe marina)
jump off	të dalunit nga llogoret për të sulmue, largimi nga vija e frontit për në sulm, fillimi i nji sulmi

landing force	trupa zbarkuese
lanyard	litár i fortë me ganxhe për të zbrazë disa lloj topash
launcher	vegël e posaçme (lloj pushke) për të hudhë granata e raketa
liaison	ndërlidhës, ndërlidhje
lieutenant	toger
lieutenant colonel	nënkolonel
limiting points	pika e mbarimit dhe e fillimit të përgjegjësis së dy njësive
line of departure	pikënisje, vija e frontit prej nga fillon sulmi
listening post	vend i fshehët vëzhgimi prej nga njoftohen veprimet e armikut
listening silence	nji kohë e caktuame kur radioja përdoret vetëm për të ndigjue
litter	vig, shkalc
log (record of events, journal)	ditár
logistics	logjistikë, intendencë
lot (specific group)	numri ase emni që u epet materialevet të ndryshme
machine gun (light) (heavy)	mitraloz (i lehtë) (i rëndë)
main attack	mësyemje kryesore
main body	trupa bazë
main line of resistance (M.L.R.)	vija kryesore e qëndresës

main supply road	rrugë e veçantë për të furnizue nji njisí; rrugë kryesore e furnizimeve
maintenance	mirëmbajtje
major	major
maneuver	manevër
manning table	kuadër personeli dhe detyrat e secilit
map	hartë, paraqitje grafike në plane e harta
march	marshim
marching fire	shtimje në marshim e sipër (tue sulmue)
martial law	shtetrrethim
mass	përqëndrim trupash luftuese dhe zjarmi
material	material (ushtarak)
mechanized	i mekanizuem
medal	dekoratë, medalje
medical corps	trupi mjeksuer, trupa shëndetsore
message	lajm, komunikim, kumtim
message center	qendër marrëse e shpërdase lajmesh e njoftimesh
messenger	lajmtár, korier
microphone	mikrofon
military	ushtarak
military crest (terrain)	kreshtë, kurriz mali
military mission	mision ushtarak

military police	policí ushtarake
mine (antitank) (antipersonnel) (naval)	minë (anti-tanks) (kundër njerzish) (uji)
mine field	fushë e minueme
misbehavior	trathtí, mungesë trimnije
mobile defense	manovrim rë mprojtje
mobilization	mobilizim
monitor	radiondigjues (për të mbledhë sidomos lajme nga anmiku; kontrollues lajmesh që dërgohen me çdo mjet)
morning report	raport i mëngjesit, raport i përditshëm ku tregohet: fuqija e njisís, gjendja e saj, sa prezent, sa me leje, sa të sëmundë, etj.
mortar	mortajë
motor pool	autopark
munitions	municion
mutual support	ndihmë reciproke
napalm	napalm; bombë djegëse (napalm âsht landa djegëse që âsht në bombë:benzinë e xhelatinë. Hudhet nga aeroplani sidomos mbi trupa)
navigator	ai që tregon udhën në dét ase n'ajr
navy	marinë
net	rjetë, rjetë radiostacionesh
neutralize	me neutralizue
noncommissioned officer	nënoficer

nurse	infermiere, infermier
objective	objektiv
oblique	i pjerrët
observation post (O.P.)	veni vëzhgimi
occupy	me pushtue me zaptue
offensive	ofensivë
officer	oficer
operations map	hartë operacionesh, hartë ushtarake
ordnance	armë dhe material ushtarak; dega e ushtrís që merret me mirëmbajtjen e armëvet
organization	njisí ushtarake, kuadri i nji njisije
outflank	me i marrë krahët anmikut
outpost	pararojë
outpost line of resistance (O.P.L.R.)	vija e qëndresës së pararojës
overhead fire	zjarm përmbi kokat e trupavet mike
overlay	skicë në letër të tejpashme; skemë
pack	pajisjet që bán nji ushtár në shpinë; barra e kafshëvet bartëse
panel	shêja që përdoren në front për t'u tregue aeroplanavet miq ku fillon fronti; copa të mëdhaja pëlhure të lyeme me nji mjet kimik që shëndritë
parachute	parashutë

parapet	grumbull dheu për mprojtje përpara llogorevet
pass (terrain)	qafë mali, grykë mali
patrol	patrullë
penetration	depërtim
perimeter	perimetër
phase line	vend ndalimi trupash për riorganizim
photo map	hartë fotografike, riprodhimi i nji fotografije të marrun nga ajri
pillbox	fortifikatë betoni (për mitraloza, armë anti-tanks etj.)
pilot	pilot
pipeline	tubacion; udhë nëpër të cilën kalon personeli ushtarak ase materiali ushtarak nga baza në vendin e përdorimit
pistol	revolver
platoon	togë
plunging fire	predhë që bie në tokë tue plasë në nji kand të gjânë
point	pikë orientimi; patrullë që shkon përpara; maja e nji predhe; me marrë shêj; pikë
pontoon	trap, barka e lundra mbi të cilat mbështetet nji urë provizore
port	skele, port, limâ; frangji në nji fortifikatë
position	pozicion

powder	barut
preventive maintenance	r[illegible] dhe mirëmbajtje e a[illegible]etevet, armëvet etj.
prime mover	automjet për të tërhjekë nji top, etj.
primer	çdo mjet që përdoret për të ndezë eksplo[illegible]ivin që vê në lëvizje predhën
priority	të vûmit nërradhë të parë të çdo gjâje me rândësí
prisoner (of war)	rob lufte
private	ushtár
private first class	tetár
property	pronë (ndërtesa,tokë,etj.)
protective clothing	rrobe të posaçme kundër gazeve etj.
provost marshall	komandanti i policís ushta-rake
pursuit	ndjekje, me ndjekë anmikun në tërheqje
pyrotechnics	fishekzár, raketë
quadrant	kuadrant, raportor, instru-ment gradimi për topa
quartermaster	oficer (i naltë) intendence
radar	radar
radio	radio
radio navigation	të gjetunit e drejtimit për dét ase për ajr me anë të radios
radio net	rjetë radiostacionesh

radio silence	për t'a mbajtë sekret urdhënin e sulmit radiot nuk përdoren veçse pak minuta para se të fillojë mësymja
railhead	vend i posaçëm në nji hekurudhë ku shkarkohen dhe shpërdahen furnizimet
rallying point	vend mbledhje i nji njisije për t'u riorganizue mbas nji beteje a luftimi
range	largësí; rreze; largësija në mes nji arme dhe objektivit; largësija e objektivit
range finder	telemetër
rank	gradë
rate of fire	sasija e të shtimevet në nji minut
rating	specialist ushtarak (pilot, etj.)
rations	racione
rear	mbrapavijë
rear echelon	pjesa e ushtrís që rri në mbrapavijat e cila administron dhe furnizon ushtrín
rear guard	mbraparojë
receiver (radio)	radiomarrëse
reception	qendër ushtarake që i cakton njisín nji ushtari i ep pajisjet etj.
recoilless rifle	lloj pushke që nuk zmbrapet kur zbrazet, armë që nuk zmbrapet kur zbrazet
reconnaissance	vëzhgim

recruit	rekrut
redeployment	transferim administrativ njisish prej nji vendi në nji tjetër
reference point	pikë konturore, shêj a pikë drejtimi e lehtë me u-gjetë në teren
regiment	regjiment
regimental combat team	skuadër a grup luftimi të nji regjimenti
reinforce	me riforcue
relay	me bâ gati topin për të shti përsëri; me shëpirrue, shndërrim
relief	reliev; largim nga detyra; zâvendësim; zâvendësimi i nji njisije me nji tjetër
reorganize	me riorganizue
replacement	zâvendësim
requisition	kërkesë (për personel a material)
reserve	rezervë
retire	me u-tërhjekë; me dalë në pension
retreat	tërhjekje(e detyrueshme)
retrograde movement	tërhjekje taktike ase e detyrueshme e nji komande
reverse slope	ana tjetër e shpatit
ridge (terrain)	kreshtë mali
rifle	pushkë
rifleman	pushkátar

river line	bregu i lumit nga ana e mprojtsit
road block	barikadë, pengesë në rrugë
road net	rjetë rrugësh
rocket	roketë, misil, bombë me reaksion
rocket launcher	roketë hudhse, misil hudhse, hudhse bombash me reaksion
roll call	apel, thirrje emnash (thirrja emën për emën)
route	rrugë, hikja e nji ushtrije së thyeme në shrregullim; me vû anmikun në të hikun
runner	lajmtár kambsuer
sabotage	sabotim
saddle (terrain)	kurriz që bashkon dy maje malesh më të nalta
sailor	detár, marinár
salient	pjesa e zonës së betejës që shtrihet drejt për drejtë kundrejt frontit
salvage	automjete etj. të prishuna pjesët e të cilave mund të përdoren; grumbullim veglash ase maqinash të nxjerruna jashtë përdorimi
scabbard	këllef arme, millë
scar	mbresë, vrajë
scout	kallauz, njeri që njef terenin anmik, njeri që vete në mbrapavijat anmike për të mbledhë informata

screen	maskim; tansija e veprimevet që bâhen për t'i fshehë armikut çdo gjâ
secondary position	pozicion i dytë
secret	sekret
section	sekcion
sector	sektor
security	sigurim, masë sigurimi
self-propelled	vetëlëvizës, që shkon vetë
sentry post	vendi i rojës
sergeant	kapter
shell	predhë, gjyle topi
shelter	strehim (për mprojtje)
shock action	veprim i rrufeshëm në sulm
shore	breg deti, breg liqêni, breg lumi
shrapnel	shkrapnel, shrapnel
signal	sinjal
signal operation instruction (SOI)	udhëzime mbi përdorimin e sinjalevet
skirmish	luftim i vogël, luftë patrullash
slit trench	llogore nën dhé që ka pothuej formën e nji kanddrejti
small arms	armë të lehta
smoke	tym, tym si mjet maskimi
sniper	snajper, ushtár që shtie nga nji vend i fshehët

soldier	ushtár; ushtarak
spearhead	trupat që udhëheqin nji sulm
squad	skuadër
squadron	njisí mesatare në flotën ajrore; njisí taktike e administrative në kalorí
staff	shtab
staging area	vend kontrollimi dhe furnizimi trupash afër nji limâni para se të nisen
strafe	me mitralue me aeroplan nga afër(trupa e objektiva në tokë e anije në dét)
submachine gun	pushkë e shkurtë automatike, mitraloz dore
submarine	nëndetse
sump	gjiriz; gropë kullimi ujnash së ndytë
supply discipline	disiplinë që ushtrohet në të kursyemit e furnizimevet
supply point	vend furnizimesh, depo, pikë furnizimesh
support	ndihmë ase mprojtje(që nji njisí i ep nji tjetre)
sustained defense	difensivë a mprojtje që sŷnon me ndalue sulmin e anmikut në vijën e mprojtjes
tactical	taktik
tactical air support	ndihmë taktike ajrore (që u epet fuqivet toksore)
tactics	taktikë

tank	tanks
tank dozer	tanks-bulldozër, tanks i rregulltë që ka nji paftë hekuri si thikë përpara për të largue dhé
target	nishan, shêj, objektiv ase grup objektivash; zonë ku drejtohen të shtimet
task force	bashkim i përkohëshëm njisísh nën nji komandë për kryemjen e nji misioni të veçantë
teletype	maqinë telegrafike që shkruen automatikisht
terrain	teren
thrust line	dy pika të caktueme në nji hartë e të lidhuna me nji vijë (përdoret si referencë për të dhânë pozicione tjera)
time fuze	sigurecë me sahat
tracer (ammunition)	predhë-raketë, predhë me dritë
trains (combat, field)	trena (fushorë,luftimi)
transmitter	radiodhânëse, radiotransmetuese, aparat trensmetues
transportation	transportim
treadway	binar hekurudhe mbi disa lloj urash
trench	llogore; hendek për mprojtje
trip-wire	tel i ngritun pak përmbi dhé me qëllim që të marrin më thue trupat anmike
troops	trupa (njisí administrative e taktike ushtarake)

truce	armëpushim
truck	kamion
truckhead	vend ku shkarkohen furnizimet prej kamionavet (dhe ngarkohen ndër trena)
turning movement	lëvizje për të dalë mbrapa armikut (me qëllim për të sulmue nji objektiv tjetër që gjindet thellë mbrapa frontit armik pa ndeshje të mëdhaja me 'të)
uniform	uniformë
unit	njisí
urgent	urgjent
veterinary	veterinarí
warning net	rjetë mjetesh që lajmon lëvizjet e armikut dhe të aeroplanavet e anijevet të tij (radio,radar,etj.)
warrant officer	degë e veçantë oficerash teknikë të fuqivet t'armatosuna (kanë vetëm katër grada)
water point	vend i posaçëm për të nxjerrë ujë
weapons	armë
windage	ndikimi i erës (që i ndërron drejtimin predhës)
withdraw	me u tërhjekë, tërhjekje, me u-tërheqë, tërheqje
wound	me plague, plagë

zero	të rregulluemit e shinjestrës në mënyrë që të qëllohet shëji mu në mes tue marrë parasysh naltësín dhe ndikimin e erës, objektivi në shinjestër
zone	zonë